



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.10.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimin të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (vijim nga mbledhja e datës 26.09.2019).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
- 8. Erion Fejzulla, USAID.*
- 9. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 10. Valbona Bala, USAID.*
- 11. Gregor Borkowski, EURALIUS.*
- 12. Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimin të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (vijim nga mbledhja e datës 26.09.2019).

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni në dijeni sot do të fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 22 tetor 2019. Në këtë mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët. Sikurse ju kemi vënë në dijeni lidhur me rendin e ditës, sot në rendin e ditës kemi disa çështje: Çështja e parë, ka të bëjë me vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Çështja e dytë, ka të bëjë me shqyrtimin i projektvendimit “Për komandimin e znj. {...} si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës”. Çështja e tretë, ka të

bëjë me deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit. Çështja e katërt, ka të bëjë me shqyrtimin i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 vit”. Çështja e pestë, ka të bëjë me shqyrtimin i projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatit nga radhët e juristëve të spikatur, z. {...}, për në Gjykatën e Lartë”. Çështja e fundit është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët, {...} dhe {...}.

Nëse nuk keni ndonjë gjë lidhur me rendin e ditës. Kemi ndonjë diskutim? Atëherë, kalojmë në... Po!

Brikena Ukperaj: Atëherë, lidhur me pikën e fundit të rendit të ditës, për kualifikimin e dy kandidatëve për magjistrat, për të filluar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, unë do të propozoja që të shtyhej trajtimi për një mbledhje tjetër, për shkak se materialet janë voluminoze, duhen parë më me imtësi dhe në detaj dhe për faktin tjetër që, këto janë standardet e para që vendosen nga Këshilli dhe secili duhet të ketë qëndrim... Në fakt unë flas për veten time. Nuk jam, domethënë nuk kam një qëndrim të kristalizuar sot lidhur me çështjen. Prandaj kërkoj që të shtyhet për një datë tjetër.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj.

Atëherë, jemi dakord lidhur me propozimin për ta shtyrë, për ta hequr nga rendi i ditës dhe shtyrë në një mbledhje tjetër shqyrtimin e këtyre, e këtij projektvendimi për kualifikimin e kandidatëve për Shkollën e Magjistraturës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Unë kam vetëm një merak, duke qenë se diskutimi i kualifikimit ose jo kualifikimi i këtyre dy kandidatëve është një çështje prioritare sepse Shkolla e Magjistraturës ka filluar mësimin, mbarëvajtjen e mësimit dhe komplet mbarëvajtjes së shkollës, ju sjell në vëmendje se do të ishte mirë që këto dosjet dhe informacionet lidhur me këto dy kandidatë të shqyrtohen brenda një kohe shumë të arsyeshme për të vlerësuar sa më shpejt. Në mbledhjen e radhës. Po! Faleminderit.

Atëherë kalojmë në shqyrtimin e çështjes së parë të rendit të ditës, e cila nuk është një çështje për herë të parë në rendin e ditës, e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e kaluar, para, pothuajse u bë një muaj, pra behet fjalë për raportin “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e Inspektoreve të ish–Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Ky është një raport i përgatitur nga një Komision i ngritur, një Komision i Përkohshëm, i ngritur me vendim të Këshillit, që ka të bëjë me vlerësimin e statusin individual dhe karrierën e këtyre Inspektoreve që kanë qenë pranë ish–Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Siç jeni në dijeni, pothuajse një muaj më parë, jemi mbledhur dhe kemi diskutuar mbi punën dhe raportin e Komisioni të Përkohshëm të ngritur për këtë qëllim. Duke qenë se gjatë mbledhjes së mëparshme u kërkua nga ana juaj më tepër kohë për shqyrtimin dhe dokumentacionin si dhe formësimin të qëndrimit, vendimmarrjes për miratimin e këtij lloj raporti, me propozimin tuaj, shqyrtimi i këtij raporti u shty në një mbledhje tjetër, pasi të qartësohej situata për secilin kandidat.

Besoj se sot jemi gati për të diskutuar dhe një herë çështjen e statusit individual të inspektorëve dhe për të marrë një vendim dhe për këtë arsye unë kërkoj që t’ia jap fjalën kryetarit të këtij Komisioni, z. Medi Bici.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare! Ashtu siç e thatë edhe ju, çështja e inspektorëve ka ardhur edhe në një seancë tjetër në mbledhje plenare, ku Komisionit iu lanë tre detyra, të cilat mendoj që janë zbatuar nga Komisioni.

E para është verifikimi i diplomave në Fakultetin Juridik për të gjithë inspektorët dhe me shkresën me nr. 1129/2 prot., datë 16.10.2019, të Fakultetit të Drejtësisë, i është

dhënë përgjigje Këshillit të Lartë Gjyqësor për të nëntë inspektorët dhe Kryeinspektoren, të cilët rezultojnë se kanë mbaruar Fakultetin Juridik në programe të ndryshme;

Gjithashtu, ka patur një problem me inspektorin {...} për arsye se me datën 1 janar të vitit 2019, ai ka mbushur moshën për pension dhe Komisioni e ka pasqyruar këtë fakt në relacionin e tij, pjesa e fundit, ku është me *'bold'* gati një faqe, janë thënë të gjitha ato arsye, por megjithëse unë mendoj që ne sot kemi vetëm për të përcaktuar statusin, dhe kjo i përket një komisioni tjetër;

Dhe detyra e tretë ka qenë nxjerra e të gjithë akteve, kërkesave që kanë bërë inspektorët e ndryshëm në periudha, gjatë gjithë kohës që kanë punuar këtu dhe nga administrata janë nxjerrë të gjitha dokumentet dhe u janë vënë të gjithë natarëve në dispozicion. Kështu që, mendoj që nuk ka më arsye për të mos vazhduar.

Meqenëse Komisioni, siç u tha radhën tjetër, ka qenë në mendim unik për sa i përket 4 magistratëve, inspektorëve {...}, {...}, {...} dhe {...}, të cilët nuk e kanë shkëputur punën nga gjykata në momentin që kanë ardhur inspektor, pra kanë ardhur direkt nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, mendoj që ta fillojmë shqyrtimin me këto të katërt dhe pastaj kalojmë tek inspektorët juristë. Për këtë fjalën ia jap zonjës Fatmira.

Fatmira Luli: Po! Atëherë shkurtimisht po parashtroj relacionet për katër inspektorët, të cilët ne kemi mendim unik, që e gëzojnë statusin e gjyqtarit: zonjën {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Për të mos u zgjatur shumë, relacionet kanë pothuajse të njëjtën strukturë lidhur me dispozitat ligjore që referojnë dhe kanë veçantitë se secili ka eksperiencën të ndryshme pune dhe arsyetimin për secilin.

Po lexoj të parin lidhur me gjithë dispozitat në formë të plotë dhe të tjerët pastaj po lexoj vetëm detajet që sa secili, diferencat që ka secili në eksperiencat e punës.

Në zbatim të nenin 62 të ligjit 115/2016 “Për qeverisjen vendore të sistemit të drejtësisë” dhe nenit 168 të ligjit po 168/2016 (*lapsus ligji, duhet ligjit 96/2016*) “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin 59 ngriti Komisionin e Përherëshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili pasi shqyrtoi të gjitha materialet që ndodhen të arkivuara pranë Këshilli i Lartë Gjyqësor, përgatiti dhe relacionin përmbledhës.

Për Inspektoren {...} (*lapsus, pasi mbiemri është {...}*) nga dokumentacioni që ndodhet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është konstatuar që ka lindur në Korçë 10.03.1980. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetin e Tiranës në vitet akademike '99-2003, më pas ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitet 2003-2006. Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, zonja {...} është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me dekretin 5107, datë 06.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Me vendimin 345, datë 05.07.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë bazuar në ligjin 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ndryshuar me rregulloren “Për organizimin e funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar me vendimin 195, datë 05.07.2006 të po këtij Këshilli, është emëruar zonja {...} në detyrën e inspektore, pozicion të cilin e mban aktualisht edhe sot. Zonja {...} ka punuar në seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave. Që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e nëpunësit vlerësues përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve në zbatimin të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në strukturën e re që ka miratuar Këshilli i Lartë Gjyqësor bën pjesë edhe Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve me përbërje 5+1, detyrë që më parë e kanë kryer një pjesë e këtyre inspektorëve që kanë punuar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe që kanë përvojë në këtë drejtim, përvojë të pasur në këtë drejtim dhe për këtë flasin rezultatet e vlerësimeve të tyre nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Në nenin 3/10 të ligji 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” është parashikuar se: Organi i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka funksionuar sipas ligjit 8811, datë 17.05.2011 (*lapsus, pasi është 17.05.2001*) “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Prandaj, Komisioni i Përkohshëm është i mendimit që kjo detyrë duhet të vazhdojë të kryhet nga një strukturë e specializuar. Sugjerimet për inspektorët janë bërë bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit 8811/2001 për Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe nenit 168 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”.

Bazuar në nenin 168 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” ku parashikohet se: Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë kanë statusin e gjyqtarit dhe

ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ato i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, bazuar në faktin se zonja {...} mban statusin e gjyqtarit dhe vjen nga radhët e gjyqtarëve si inspektore në ish- Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe vazhdon mandatin e saj të dytë si inspektore, Këshilli (*lapsus, Komisioni*) i Përkohshëm sugjeron... Veç kësaj, zonja {...}, me mbarimin e mandatit e parë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ka paraqitur kërkesë para Këshillit të Lartë të Drejtësisë për t'u emëruar gjyqtare, ka paraqitur disa kërkesa. Këto kërkesa mbajnë datën 03.05.2010, 25.02.2011, 05.01.2012, 01.10.2012, 26.11.2012, 03.01.2013, 24.06.2013, 08.05.2014, 18.07.2016, 09.11.2016. Të gjitha këto kërkesa janë bërë për vende të ndryshme pune të shpallur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për gjyqtaren, në qytete të ndryshme të Shqipërisë, kërkesa të cilat nuk janë marrë në shqyrtim, nuk janë pranuar dhe ajo ka vazhduar të ushtrojë detyrën e inspektore në Ish-Këshillin e Lartë Gjyqësor (*lapsus, të Drejtësisë*).

Atëherë, bazuar në nenin 168 të ligjit 96/2016 dhe nenit 283 të ligjit 115/2016 Komisioni propozon vazhdimin e detyrës së inspektore, konfirmon statusin e gjyqtares dhe vazhdimin e detyrës së inspektore përgjegjëse në Njësinë Mbështetëse të ngritur pranë Komisionit përkatës për Vlerësimin Profesional ku ruhet statusi i magjistratit dhe paga e gjyqtarit të apelit, deri në krijimin e zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Ky është propozimi, për zonjën {...}, nga të tre anëtarët e Komisionit. Është me variante, por ky është propozimi i vetëm që kemi ne. Për {...}n, për {...} vetëm një propozim ka, s`ka dy propozime.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo, ne lamë përfundimisht të shprehemi vetëm për statusin në mbledhje, të mos shprehemi për gjëra tjera, të shprehemi vetëm për statusin e gjyqtarit dhe të drejtën e saj që të vazhdojë të punojë. Për të tjerat nuk do shprehemi në këtë mbledhje.

Në këto kushte do të vazhdojmë edhe për inspektorin...

Naureda Llagami: Atëherë si mendoni të procedojmë për çdo... Duke qenë se janë akte individuale, të kalojmë në votimin e aktit, propozimit të bërë.

Pra ka mundësi ta lexosh edhe një herë në mënyrë vendimmarrjeje, çfarë propozoni të vendosë Këshilli, që ta hedhim në votim.

Fatmira Luli: Propozimi i projekt-aktit është: Konfirmimin e statusit, të konfirmojë statusin e magjistratit për znj. {...} (*lapsus, pasi mbiemri është {...}*) e emëruar si inspektore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Zonja {...} komandohet të ushtrojë detyrën e nëpunësit përgjegjës për Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetarja e Këshillit dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është propozimi i projekt-aktit, që është për miratim para këtij Këshilli.

Naureda Llagami: Për të qenë pak më të saktë lidhur me propozimin.

Pra në thelb propozimi është... Unë doja vetëm që ta riformuloja, në vijimësi të asaj që ju thatë. Atëherë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni është: Të konfirmojë statusin magjistrat për znj. {...}. Znj. {...} komandohet të ushtrojë detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në krijimin e zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jeni dakord.

Kalojmë në votim.

Brikena Ukperaj: Dakord me thelbin, por unë do të propozoja formulim të ndryshëm. Jo ‘konfirmim’ por ‘deklarim’ sepse vendimi i Këshillit për pasjen apo jo të statusit të gjyqtarit është një vendim deklarativ sepse statusi fitohet me vërtetim të disa rrethanave ligjore. Konfirmimi do të thotë që ti ia nënshtron shqyrtimin dhe ai mund ta ketë patur por s’e ka në vazhdim.

Prandaj do të propozoja që termi i përdorur të jetë: “Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit të znj. {...}”. Dhe pika e 2-të: “Vijimin e ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të zn. {...}, deri në krijimin e ILD-së”.

Dhe diçka tjetër, për pjesën pse është formuluar pika e dytë “deri në krijimin e ILD-së”.

Znj. {...} ka statusin e gjyqtarit, e ka plotësuar një mandat 5-vjeçar si inspektore në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, mandej ka një vendim të KLD-së për zgjatjen e mandatit të saj, deri në krijimin e ILD-së. Nga ana tjetër, referuar ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vetëm në rastin e inspektorëve të ILD-së parashikohet e drejta që ata mund të kenë riemërim të njëpasnjëshëm, pra mund të ndodhë që inspektorja aty mund të marrë 2 mandate 5-vjeçare të njëpasnjëshme.

Pavarësisht se ajo e ka kaluar periudhën 5-vjeçare të komandimit, në përputhje me ligjin, nuk ka asnjë ndalim që të vazhdojë një periudhë komandimi deri në një periudhë 10-vjeçare.

Prandaj mendoj që formulimi që propozova është ezaurues, për sa i përket statusit dhe të marrëdhënieve të punës së kësaj inspektoreje, deri në krijimin e ILD-së.

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me formulimin e propozuar nga znj. Ukperaj, jemi dakord ta lemë kështu?

Kemi sugjerime lidhur me formulimin e dispozitivit të vendimit?

(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Brikena Ukperaj: Pika e 1-rë është: Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit të znj. {...}. Pika e 2-të: Vijimin e ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik, të zonjës {...}, deri në krijimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

Ilir Toska: A mund të them një propozim, për formulimin e pikës 2?

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Mendoj që, mos ishte më korrekte të thoshim që, magjistratja {...} komandohet të vijojë të ushtrojë detyrën. Sepse ajo është dhe është komandim kjo. Do duhet të konsiderohet termi ‘komandim’, kuptohet... Propozimi i parë ka termin ‘komandim’. Propozimi që bëri Brikena nuk ka përdorimin e termit ‘komandim’.

Brikena Ukperaj: Ta them pse nuk është përdorur termi ‘komandim’?

Sepse ka një organ që e ka komanduar atë tashmë. Nuk është se ne do ta komandojmë. Ajo vazhdon një procedurë komandimi, të cilën ex lege e gëzon deri në momentin e krijimit të ILD-së.

Ilir Toska. Komandimi që ka zonja {...} është për inspektore. Sot jemi duke bërë fjalë që të vijojë të ushtrojë detyrën nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit. Nuk është vijim. I bie që praktikisht kemi rikonsideruar pozicionin e komandimit, pra i bie që të qartësojmë që të vijojë komandimin tashmë tek ky pozicioni që kemi.

Brikena Ukperaj: Formulimi dakord. Por këtë gjë që ju thoni, e përcakton ligji, sepse ligji përcakton që për shkak të trashëgimisë institucionale, deri në momentin që do krijohet ILD-ja, të gjithë inspektorët do të vazhdojnë të punojnë pranë KLGJ-së.

E vetmja strukturë që ne kemi është Njësia e Vlerësimit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin sipas variantit të bërë nga Komisioni, me ndryshimin e propozuar nga znj. Ukperaj, që në vend të termit “të konfirmojë statusin”, “deklarimin e pasjes së statusit magjistrat për zonjën {...}”. Më pas, për pikën e dytë...

Kalojmë këtë njëherë si ndryshim dhe më pas bëjmë ndryshime tek pika e dytë. Okej?

“Deklarimin e pasjes së statusit magjistrat për zonjën {...}”, pika e parë.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë lidhur me formulimin e pikës së dytë të vendimit, që ka të bëjë me, varianti i komisionit ishte: “Zonja {...} komandohet të ushtrojë detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri ne krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Propozimi i bërë nga zoti Toska ishte: Zonja {...} komandohet të vijojë të ushtrojë detyrën?

Kalojmë me propozimin e bërë nga zoti Toska.

Ilir Toska: ... “të vijojë komandimin”. Nëse nuk është e qartë kjo gjë, gjeni një formulim tjetër. Magjistratja filan të vijojë komandimin në detyrën filan. Kaq thashë unë. Po qe kaq e paqartë.

Naureda Llagami: Hidhet në votim propozimi i bërë nga z. Toska që: “Zonja {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri ne krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kalojmë te subjekti tjetër që është zoti {...}.

Fatmira Luli: Inspektori {...} ka lindur në Gramsh më 15.05.1971 dhe është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike ‘94-‘98. Më pas ai ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike ‘98-2001. Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës zoti {...} është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd me Dekretin 3111, datë 02.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Me vendimin 219, datë 17.12.2007 ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë, bazuar në ligjin 8811 të 2001 “Për organizimin e funksionimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”

dhe ndryshuar me rregulloren përkatëse, miratuar me vendimin 195, 05.07.2006 të po këtij Këshilli, e ka emëruar zotin {...} inspektor. Pas përfundimit të mandatit të parë si inspektor, me vendimin 302/2012 të po këtij Këshilli ai ka marrë edhe një mandat të dytë në detyrën e inspektorit, ndërsa me vendimin 17, datë 24.01.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atij i është zgjatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Zoti {...} ka paraqitur kërkesa në ish- Këshillin e Lartë të Drejtësisë për t'u emëruar si gjyqtar më datë 27.11.2012 (pas mbarimit të mandatit të parë), dhe kërkesën tjetër e ka bërë në 01.07.2016 për të punuar si gjyqtar në gjykata të ndryshme të vendit. Kërkesa që s'janë marrë në shqyrtim nga Këshilli, s'janë pranuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në bazë të Urdhrit nr. 08, datë 19.04.2013 të titullarit të KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione, zoti {...} është caktuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 e kryen këtë detyrë të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarit, në zbatim të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në strukturën e re që ka miratuar KLGJ bën pjesë edhe Njësia e Vlerësimit në të cilën ka punuar nga 2017 zoti {...}. Në nenin 3/10 të ligjit 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” është parashikuar se organi i vlerësimit të aftësive është Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, i cili ka funksionuar me ligjin 8811 “Për organizimin dhe funksionimin të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, prandaj Komisioni i Përkohshëm është i mendimit që kjo detyrë duhet të vazhdojë të ushtrohet nga struktura e specializuar që ndodhet brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bazuar në nenin 168 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në të cilën parashikohet se inspektori dhe kryeinspektori në detyrë të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionin në Këshillin e Lartë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Bazuar në sa më sipër, meqenëse zoti {...} ka punuar gjyqtar dhe është komanduar brenda 2 afateve të komandimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, mban statusin e

gjqtarit sepse vjen nga radhët e gjyqtarëve si inspektor dhe ka përfunduar mandatin e dytë si inspektor i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioni është i mendimit të konfirmojë statusin e gjyqtarit ose të deklarojë (siç u shprehën këtu) statusin e gjyqtarit të këtij magjistrati dhe t'i krijojë mundësinë atij për t'u emëruar në gjykatën e rrethit nga ka ardhur ose në gjykatë tjetër të shkallës së parë ose të apelit, në rastin e shpalljes të këtyre vendeve vakante nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ky është propozimi i Komisionit i cili është bërë edhe me projekt-aktin që duhet ta ndryshojmë sipas formulimit, “të konfirmojë statusin e magjistratit”, “të deklarojë statusin e magjistratit për z. {...} dhe i njeh të drejtën atij të kthehet në sistemin gjyqësor sepse ai ka përfunduar afatet e komandimit.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Pika e 2-të, të kthehet në vendin e mëparshëm? Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Fatmira Luli: Po, të kthehet!

Atëherë, të shprehemi vetëm me deklarinimin e statusit magjistrat.

Në rregull atëherë, shprehemi vetëm për deklarinimin e statusit të magjistratit. Meqenëse ka përfunduar afatet e komandimit, nuk ka pse shprehet ky Këshill për vijimin e punës në Inspektorat apo ta trajtojë në një mbledhje tjetër, nëse do ketë.

Nuk kemi pse shprehemi në këtë mbledhje.

Në punë do vazhdojë ai, derisa t'i krijohet mundësia të emërohet gjyqtar në një vend tjetër.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska. Atëherë kam një propozim për të riformuluar në lidhje me inspektorin {...}. Është e njëjta gjë që diskutuam e për zonjën {...}, por me diferencën që për vijimin e mëtejshëm të marrëdhënies së punës, nëse për zonjën {...} konsideruam deri në krijim e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për zotin {...} e kemi të pamundur të konsiderojmë këtë gjë për shkak se ai ka ezauruar afatin 10-vjeçar. Kështu që, për të sistemuar në sistem zotin {...}, do duhet ta konsiderojmë në një vendimmarrje tjetër.

Propozimi konkret është: Deklarimi i pasjes së statusit të magjistratit për zotin {...}. Zoti {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit

Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë sugjerim?

Brikena Ukperaj: Po, vetëm se situata e zotit {...} me zonjën {...} nuk është e njëjtë për sa i përket shprehjes “vijimin e komandimit”. Në kushtet kur i ka mbaruar afati 10-vjeçar nuk mund të shprehemi që të vijojë komandimin në këtë strukturë derisa ne ta marrim në shqyrtim. Kështu që, “vijimin e ushtrimit të detyrës”, prandaj dhe unë i mëshova radhën e parë që të gjitha rastet duhet “vijimin e ushtrimit të detyrës”, jo “vijimin e komandimit”. Po nuk është komandim sepse për sa kohë Këshilli i jep vetes kohë që ta rimarrë në shqyrtim në një mbledhje tjetër, ai do të vazhdojë të ushtrojë detyrën...

Ilir Toska: Është periudhë komandimi apo jo?

Brikena Ukperaj: Është periudhë komandimi, por tej afatit 10-vjeçar nuk mund ta mbajmë të komanduar gjyqtarin.

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Toska: Mos duhet ta bëjmë javës tjetër, por kjo nuk do të thotë që...

Nga sot ai është i pa komanduar. Nuk e di se çfarë statusi ka zoti {...} mbas 10 vjetësh, është i komanduar apo jo? Nëse s’është...

Brikena Ukperaj: Ai vazhdon të jetë gjyqtar i komanduar në Këshillë, por duke thënë vijimin e komandimit për një afat mbi 10 vjet... Okej, në rregull.

Brunilda Kadi: Mundem?

Naureda Llagami: Po!

Brunilda Kadi: Atëherë, në lidhje me propozimin që bën vetë Komisioni, në qoftë se, besoj prej tyre është konfirmuar, që nga cila gjykatë ka ardhur gjyqtari, ka rezultuar që gjykata është suprimuar dhe kompetencat e saj territoriale kanë kaluar tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në këtë gjykatë ka sot një vend të përhershëm të lirë, unë nuk e kuptoj pse duhet ta shtyjmë sepse atij i takon kjo e drejtë. Në mënyrë automatike, ne s’kemi pse diskutojmë. Nëse ka vend pastaj, kur të ketë lëvizje paralele, promovime dhe ai i plotëson kriteret, si të gjithë të tjerët të kandidojë, le ta diskutojmë.

Unë nuk e kuptoj ku është arsyeja që ne duhet ta shtyjmë?!

Sepse kemi ngërçin tjetër. Ai nuk mund të vijojë, edhe kaq sa ka vijuar, ishin probleme që janë diskutuar pse nuk i kemi diskutuar më përpara, por ai është sot, të paktën dy vjet përtej mandatit. Kështu që unë nuk besoj që sot kemi justifikim ligjor ta vazhdojmë këtë, le të themi paligjshmëri, jo për fajin tonë. Kështu që unë propozoj të ecet me votimin që është bërë nga Komisioni për t'u rikthyer ose caktuar (për termin, hajde ta diskutojmë) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në qoftë se konfirmohet se aty ka vend të përhershëm të lirë.

Ilir Toska: Me leje?

Në fakt, Komisioni që është ngritur dhe ka sjellë propozimin nuk është ngritur se ku do të sistemojë inspektorët. Thjeshtë është ngritur, ka pasur detyrimin, që të përcaktojë pasjen apo jo të statusit dhe vijimin e punës në Këshill. Nëse ne do të konsiderojmë, hajde të zgjidhim për të gjithë inspektorët këtë ngërçin.

Për zonjën {...} nuk e zgjidhim se s'është krijuar ILD-ja. Duhet ta kishim zgjidhur. Edhe ajo ka kaluar 5-vjeçarin. Nëse ne konsiderojmë sot që duhet të jetë në detyrë dhe ne bëjmë javës tjetër ose ta çojmë atje ku ishte, është një çështje që do të duhet ta diskutojmë paraprakisht, nuk është se është pjesë e detyrave që ka pasur Komisioni.

Propozimi që tha zonja Luli është që ai do të duhet të shkojë atje se këtë e thotë ligji nuk tha ndonjë propozim konkret në fakt.

Naureda Llagami: Atëherë mund të biem dakord që, tek detyrat e Komisionit ishte përcaktuar që së pari të diskutojmë lidhur me statusin e magjistratit apo jo, duke qenë se struktura që kemi është e përbërë nga persona që kanë bekgraund të ndryshëm dhe që këtë do vlerësonim dhe kjo ishte detyra kryesore e Komisionit; e dyta, detyra tjetër e Komisionit ishte që në zbatim të ligjit të kërkonte pëlqimin për vazhdimësinë apo jo të personave që punojnë në këtë njësi, nëse duan të punojnë pranë Njësisë së Vlerësimit dhe; e treta, më pas të identifikoheshin persona të cilët do t'i bashkohen ILD-së sipas dispozitave kalimtare të nenit 168 për Statusin. Kështu që, në tre këto detyrat unë jam dakord me zotën Toska që ne nuk jemi këtu për të përcaktuar sepse përpara se t'i caktojmë për rikthimet në vendet e mëparshme, Këshilli është në një proces që po bën vlerësimin e vendeve vakante që janë në sistem për shkak edhe të magjistratëve kështu që kjo do jetë pjesë e një vlerësimi tërësor që do bëhet nga Komisioni. Sot le të diskutojmë, së pari, statusin dhe së dyti, vijueshmëria në Këshillë deri në momentin ku janë. Këto

janë dy çështje, të paktën qëllimi i Komisionit ishte prioritar për të zgjidhur këto dy çështje. Pjesën e caktimit, jam shumë dakord, në mbledhjen më të afërt, nga Komisioni përkatës le të shihen vendet vakante, ku janë mundësitë, ku ka shkrirje gjykatash, që janë përthithur gjykatat, le të përcaktojmë vendet vakante për t'i kaluar atje. Në këto momente ne nuk mund të bëjmë dot sepse personalisht unë nga informacionet që kam nga raporti që mora, unë nuk e di nëse nga ana e Komisioni është bërë një vlerësim për vendet vakante që ndodhen në gjykatat e propozuara, si e kemi situatën.

Brunilda Kadi: Më fal, zonja Kryetare! Është e verifikuar që ka vend vakant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe këtu nuk ka vend për diskutim. Është çështje ligji. Unë nuk e kuptoj pse e duam kohën njëherë?! Çfarë do të diskutojmë këtu? Këtë e thotë ligji që “magjistrati i komanduar, në përfundim të mandatit, kthehet në vendin e tij” dhe këtu nuk ka vend për të diskutuar as për të marrë informacione shtesë dhe unë nuk e di ose hajde e shtyjme fare këtë magjistrat, këtë subjekt, dhe shprehemi njëherë e mirë për të dyja sepse mua më duket në ajër vendimi për pjesën e parë. Nuk ka asnjë lloj justifikimi as logjik, as ligjor. Unë kështu e mendoj.

Ilir Toska: Atëherë, çështja e rendit të ditës është statusi, ka apo jo, dhe vijueshmëria në Këshillë. Nëse doni që të bëjmë çështje të rendit të ditës edhe caktimin në një pozicion tjetër, hajde e bëjmë çështje të rendit të ditës. Të vijë ai që e ka për detyrë, ai i Komision, ta relatojë rastin dhe ta ndajë. Por nuk mund të themi që ne i dimë si janë rrethanat edhe meqë jemi të mbledhur, hajde i mbarojmë të gjitha. Okej!

Maksim Qoku: Të lutem, se ka një problem. Tani, ne si Komision ato detyra morëm, por problemi është që ne jemi anëtarë dhe të KLGJ-së, pra ne kemi dhe përgjegjësinë e zbatimit të ligjit. Edhe në aspektin incidental, nëse më del mua, më duhet të zbatoj ligjin. Dhe ç'kam bërë (natyrisht dhe me anëtarët e Komisionit) te relatimi? Ne kemi konstatuar që jemi jashtë afatit të komandimit dhe komandimin nuk e ka dhënë organi ynë. Ne kemi vazhduar le të themi në thonjëza një “paligjshmëri” për sa na detyron ligji të shpreheshim dhe nuk jemi shprehur dhe duhet t'i japim një natyrë kësaj vendimmarrjeje ose kësaj zgjatjeje tani, pse po e bëjmë dhe çfarë po bëjmë, kur ligji në këtë moment na detyron. Dhe ne kemi thënë në relacion që pasi deklarojmë konfirmimin, pasi deklarojmë statusin e magjistratit, ka një dispozitë imperative që na detyron ç'të bëjmë më këtë mandat objektivisht jashtë afatit, pra ka kaluar 10-vjeçari dhe personi në

fjalë po dhe çdokush tjetër nuk mundet që të vihet në inferioritet përkundrejt një shkaku objektiv, se organi nuk është shprehur. Dhe unë mendoj që ne ligji na detyron (168/2) që ta çojmë në gjykatën nga e cila erdhi dhe në analizë të faktit që gjykata e suprimuar iu bashkëngjiti gjykatës së asaj, ne kemi referuar tek vendimmarrja. –Ja, ne e kemi projektvendimin, pra: “Rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Se është detyrim që të shprehemi për aq sa në analizë të këtij subjekti ne konstatuam, dhe ligji na detyron. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi dy qëndrime lidhur me mënyrën me paragrafin nr.2.

(Zonja Fatmira Luli fillimisht flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Sikur të inkorporonim të dyja propozimet në një edhe të Ilirit edhe të Brunës duke thënë që zoti {...} të vijojë punën derisa të kthehet në vendin e mëparshëm të detyrës, t’i lëmë të dyja. S’shprehemi sot për kthimin në Gjykatën e Elbasanit. E lëmë në vendin e mëparshëm. Ose të themi, ka të drejtë të kthehet në vendin e mëparshëm të punës dhe të vijojë detyrën deri në vendimin tjetër të Këshillit.

Maksim Qoku: Kush jemi ne o Fatmira që mund të bëjmë këtë.

Fatmira Luli: Mos të shprehemi sot sepse...

Maksim Qoku: Ne na detyron ligji të ishim shprehur, -po të them! Jo më të shprehemi. Me ç’bazë ne mundet ta bëjmë këtë shtyrje?

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Ai s’ka të drejtë as të promovohet...

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në votim. Do kalojmë variantin e Komisionit i cili thotë: Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit të zotit {...}. Pika e dytë është që zoti {...} të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, gjyqtar pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kalojmë propozimin e bërë nga Komisioni dhe më pas bëjmë propozimin e bërë nga zoti Toska.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

(6 vota kundër dhe 5 vota pro.)

Atëherë kalojmë me propozimin e bërë nga zoti Toska, që fillojmë: Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit për zotin {...}. Kjo është pika e parë.

Pika e dytë është: Zoti {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarëve deri në një vendimmarrje të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Faqen Zyrtare të Internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë. Okej, e hedhim në votim.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Atëherë duke qenë se Këshilli për pikën - për pikën e parë isha dakord, se u hodh në votim pika e dytë - duke qenë se Këshilli, me shumicë votash votoi që ky magjistrat të mos kthehet në vendin e mëparshëm të punës në këtë mbledhje, jam e detyruar që ta zbatoj këtë vendim sepse është vendimi i Këshillit dhe nuk mund të lë në ajër tani vendimmarrjen në pikën e dytë. Kështu që, jam e detyruar të votoj pro sepse nuk ka opsion tjetër, nuk kam opsion tjetër, nuk kam propozim tjetër.

(Zoti Qoku flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo, jo, mendimin kundër e dhashë unë. Po tani, në këtë moment...

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Nuk u diskutua më tani, u rrëzua. Unë variant tjetër më të mirë nuk gjej, kështu që votoj pro këtij propozimi.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Kalojmë tek çështja, po, {...}. Relatimi i raportit për {...}.

Fatmira Luli: Inspektori {...} ka lindur në Mirditë me 01.03.1955. Është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës me kurs të përsheptuar në vitet akademike '93-'94.

Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 13, 24.11.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ndërsa me vendimin nr. 05, datë 01.07.1994 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me vendimin 73, datë 10.07.2015 ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë bazuar në ligjin 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar me rregulloren përkatëse, miratuar me vendimin 195, paragrafi 2, pika /a/ 05.07.2006 të po këtij Këshilli, e ka emëruar zotin {...} në detyrën e inspektorit, pozicion të cilin e mban dhe aktualisht. Gjatë periudhës së punës si inspektor ka mbuluar seksionin e inspektimit dhe verifikimit të ankesave dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e inspektorit nëpunës përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve në zbatim të ligjit 84/ 2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 3, pika 10, të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve" është parashikuar që organi i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka funksionuar sipas ligjit të mëparshëm 8811 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", prandaj Komisioni i Përhershëm është i mendimit që kjo detyrë duhet të vazhdojë të ushtrohet nga një strukturë e specializuar e këtij Këshilli që ndodhet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sugjerimet për inspektorët janë bërë duke u bazuar në nenet 14 dhe 15 të

ligjit 8811/2001. Bazuar në nenin 168 paragrafi i parë i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Shqipërisë”, ku parashikohej së inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji, ato i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Komisioni, bazuar sa më sipër, bazuar dhe në faktin se zoti {...} mban statusin e gjyqtarit dhe vjen nga radhët e gjyqtarëve si inspektor në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sugjeron për inspektorin zotin {...} si më poshtë: Të deklarojë statusin e gjyqtarit për këtë magjistrat dhe të vijojë punën/të vijojë detyrën e tij si inspektor vlerësues pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në krijimin e ILD-së.

Ky është propozimi i Komisionit i cili është i njëjtë për...

Naureda Llagami: Kemi ndonjë...

Maksim Qoku: Desha të bëj një saktësim në lidhje me faktin që duhet të shpreheshim në mënyrë vullnetare që dhënia e pëlqimit... Ai ka kërkuar që të qëndrojë tek Njësia e Vlerësimit. Nuk e ka lidhur me kohën e krijimit të Inspektoratit. Prandaj ka kërkuar të qëndrojë në Njësinë, duke ruajtur statusin e magjistratit dhe shkallën e pagës së nivelit të apelit.

Fatmira Luli: Ndërkohë ka bërë dhe dy kërkesa për të punuar si gjyqtar në datë 29.10.2014 dhe në 11.10.2016, kërkesa të cilat nuk janë marrë në shqyrtim.

Maksim Qoku: I referohemi kërkesës direkte të komisionit të punës, e cila është e 2019 dhe është një dhënie pëlqimi në lidhje me orientimin sepse për hir të së vërtetës, Komisioni i mëparshëm që na caktoi neve si Komision kishte bërë aktin e dhënies së pëlqimit dhe thuhej në aktin e dhënies së pëlqimit “Jepni pëlqimin deri në krijimin e Inspektoratit”. Kështu ka qenë në fakt kërkesa.

Por ka dallime midis inspektorëve dhe ky inspektor në fakt ka kërkuar, pra ka pranuar dhënien e pëlqimit për të qëndruar në Njësinë e Vlerësimit, pra s’ka lidhur kërkesën e tij me derisa të krijohet ILD-ja, kjo është ideja. Prandaj duhet të shohim si të shprehemi për pikën e dytë.

Naureda Llagami: Atëherë, do bëjmë propozimin e vendimit nga ana e Komisionit? Do e formuloni ju apo ta formuloj unë këtu? Atëherë, propozimi i Komisionit është: Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit për zoti {...}, -pika parë.

Pika dytë është: Zoti {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është propozimi i bërë nga Komisioni. Kemi ndonjë sugjerim?

Brikena Ukperaj: Çështja nëse inspektorët e KLD-së që janë marrë me inspektimin dhe që kanë statusin e magistratit do shkojnë apo s’do shkojnë tek ILD-ja është çështje ligji. Do shkojnë tek ILD-ja. Në momentin që krijohet ILD-ja ai inspektor në atë moment ka pastaj vullnetin nëse do, do të shfaqë vullnet ato 6 muaj që i verifikohen dhe kushtet për të vazhduar komandimin, shfaq vullnetin për të vazhduar për të qëndruar i komanduar apo do kthehet në vendin e mëparshëm të punës? Kështu që, deri në krijimin e ILD-së është detyrim që duhet ta shkruajnë për shkak të ligjit, pavarësisht vullnetit që shfaq inspektori. Prandaj mendoj që situata e zotit {...} dhe situata e zonjës {...} (*lapsus, pasi mbiemri është {...}*) janë të njëjta. Duhet të shprehemi “deri në krijimin e ILD-së”.

Naureda Llagami: Ndonjë sugjerim?

Fatmira Luli: Jo! jam dakord me Brikenën. Ai ka punuar për ankesat e Inspektoratit, për hetimin, dhe ligji dhe detyrat e mbledhjes plenare janë të hetohet ku ka punuar dhe në varësi të detyrës që ka kryer ai duhet të rrijë deri në krijimin e ILD-së. Pastaj është e drejta e tij të shprehet ku do punojë. Kështu që, ashtu duhet të bëhet dhe ky propozim. Duhet të vijojë punën, komandimin, në detyrën e përgjegjës, deri në krijimin e ILD-së.

Brunilda Kadi: Më fal, është e konfirmuar që ka qenë tek inspektimi, zoti {...}?

(*Zonja Luli përgjigjet pa ndezur mikrofonin.*)

Fatmira Luli: Po, po. Është e konfirmuar. Pas 2017-ës, siç kanë punuar të gjithë me dosjet e vlerësimit.

Brunilda Kadi: Unë mendoj që duhet të shprehemi siç u shprehëm te zonja {...} sepse çfarë do bëjë ai pastaj, ai konsiderohet i komanduar, se çfarë do zgjedhë ai të bëjë, do dorëhiqet, atë 6-muajshin që e ka ligji, kjo s’është pjesë e jona. Ne mendoj që duhet të shprehemi deri në krijimin e ILD-së, siç u shprehëm te e para. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Edhe unë jam dakord me propozimin që ka bërë zonja Ukperaj. Faleminderit!

Naureda Llagami: Hedhim në votim pra propozimin që bëri zonja Ukperaj dhe që u pranua dhe nga Komisioni pra. Pra propozimi është: Deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit për zotin {...}. Zoti {...} komandohet, jo më fal Zoti {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në krijimin e zërës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Hidhet në votim ky propozim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kalojmë me relatimin e zotit {...}.

Fatmira Luli: Inspektori {...} ka lindur në Gramsh më 01.01.1954. Është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë në vitet akademike '92-'94.

Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh me vendimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 5, datë 01.07.1994, ndërsa me vendimin nr. 5, datë 06.07.1995 të po këtij Këshilli është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gramsh. Më pas është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të suprimimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh me vendimin 235, datë 24.10.2008 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me vendimin nr. 256, pika 3, germa /b/, datë 15.06.2010 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në ligjin 8811/2001 për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ndryshuar me rregulloren përkatëse, të miratuar këto me vendimin 195, paragrafi 2, pika /a/, datë 05.07.2006 të po këtij Këshilli, Këshilli e ka emëruar zotin {...} në detyrën e inspektorit dhe me vendimin nr. 64, datë 27.05.2016 të po këtij Këshilli

ai ka marrë edhe mandatin e dytë si inspektor, pozicion të cilin e mban edhe aktualisht, pra vendimin e parë e ka në 2010, të dytin e ka në 2016, në të cilin ka marrë mandatin e dytë, të cilin po vazhdon po e ushtron.

Në bazë të Urdhrit nr. 08, datë 19.04.2013 të titullarit të KLD-së mbi ndarjen e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione, zoti {...} ka mbuluar Njësinë e Vlerësimit, Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik, dhe që prej muajit tetor ai kryen detyrën e Inspektorit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, për llogari të organeve të KPK-së, të rivlerësimit profesional. Në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar” është parashikuar që organi i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka funksionuar deri para krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me ligjin 8811/2011.

Komisioni i Përkohshëm është i mendimit që kjo detyrë duhet të vazhdojë të ushtrohet nga kjo strukturë e specializuar brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor. Bazuar në faktin që ky inspektor ka punuar gjyqtar dhe ka ardhur i komanduar në Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Përkohshëm është i mendimit që ai e gëzon statusin e gjyqtarit dhe për këtë shkak i deklarohet statusi, duhet të vijojë punën në vendin e inspektorit përgjegjës për vlerësimin profesional.

Problemi i {...}t është që ka mbushur moshën për pension por meqenëse ne, ky Komision, nuk ka për detyrë të verifikojë këto rrethana e fakte, vetëm të konfirmojë statusin dhe vijueshmërinë në punën e nëpunësit vlerësues për efekt të ligjit të ri të hyrë në fuqi për statusin e gjyqtarit dhe për qeverisjen e organeve të drejtësisë, Komisioni do shprehet në këtë mbledhje vetëm për deklarimin e pasjes së statusit të magjistratit dhe vijimin e punës së tij pranë kësaj Njësie të Vlerësimit Etik dhe Profesional. Ky është propozimi i Komisionit.

Maksim Qoku: Komisioni ndahet këtu. E di shumë mirë detyrën që kishte Komisioni, po unë e konstatoj atë në bazë të ligjit dhe është fakt natyral arritja e moshës. Në momentin që mbush moshën, pika /c/, më duket, e nenit 64, thotë që mbushja e pensionit, mbaron statusi. Prandaj edhe unë si anëtar i Komisionit kam bërë propozim tjetër: Konfirmoj statusin, por daljen në pension të magjistratit {...}.

Naureda Llagami: Atëherë, duke qenë se kemi dy propozime...

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë meqenëse u shtrua çështja e vijimit të pasjes së statusit për zotin {...}, referuar fakteve që janë parashtruar edhe nga Komisioni, zoti {...} ka mbushur moshën 65 vjeç në muajin janar të vitit 2019. Këshilli nuk ka konsideruar në këtë kohë që të deklarojë mbarimin e statusit për zotin {...}, as ta vejë në diskutim statusin dhe as të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për të. Ligji në janar, pra neni 64 përcaktonte që statusi mbaron me mbushjen e moshës së pensionit të pleqërisë, nuk kishte në mënyrë eksplicite një moshë të caktuar. Më vonë, pas muajit janar, Këshilli ka konsideruar, me interpretim, që mosha duhet të ishte mosha 65-vjeç, duke iu referuar ligjit të mëparshëm për të mos bërë diskriminim. Ndodhi që zoti {...} ka vijuar të ushtrojë detyrën dhe në muajin korrik ka ndryshuar ligji dhe ka përcaktuar tashme moshën 67 vjeç dhe, i cili ligji ka hyrë në fuqi në muajin gusht vitit 2019. Pra për momentin zoti {...} vijon të jetë në detyrë, pra të ushtrojë detyrën, ndërkohë që ligji aktualisht e përcakton si moshë të mbarimit të statusit moshën 67 vjeç, të cilën zoti {...} nuk e ka mbushur ende.

Referuar këtyre rrethanave mendoj se zotit {...}, jo vetëm duhet t'i deklarojmë pasjen e statusit, por duhet të deklarojmë vijimin e komandimit derisa ai të mbushi moshën 67 vjeç, pra që mbaron statusi për shkak të ligjit. Faleminderit!

Maksim Qoku: Me anë të kësaj i bie që të pranojmë faktin që ligji ka fuqi prapavepruese dhe nuk besoj që mund ta bëjmë dhe e dyta, arritja e moshës së pensionit është e konstatueshme në bazë të ditëlindjes së tij dhe lidhet me një pikë të ligjit që e konsiderojmë mbarimin e moshës. Ndërkohë, interpretimi për efektin e 65-vjeç e më poshtë është tjetër gjë. 65-vjeç më duket i ka bërë në janar kështu që, se nuk është shprehur Këshilli nuk do të thotë që ai duhet të vijonte për të mos dalë në pension. Faleminderit!

Marçela Shehu: Jo! Kam përshtypjen, që ajo që sqaroi edhe zoti Toska ishte kjo që, Këshilli deri tani, moshën e daljes në pension e ka përcaktuar me interpretim sepse ligji për Statusin nuk e kishte të përcaktuar moshën 65 vjeç dhe ne gjithmonë i jemi referuar ligjit për sigurimet shoqërore për të mos e lënë boshllëk.

Jo pra, nuk po them që deri tani ne kemi vepruar gabim. Por ligji nuk ka qenë i qartë dhe në korrik ligji e sanksionoi përfundimisht moshën e daljes në pension të gjyqtarit. Pra nuk ka lidhje që ne tani po vendosim që ligji të ketë fuqi prapavepruese. Ne tashmë kemi një përcaktim në ligj për pensionin.

Ky pra është diskutimi. Ne nuk po themi që kemi vepruar gabim, por ligji nuk ishte i qartë dhe ndërkohë që zoti {...}, në kohën kur bëri 65 vjeç vazhdoi dhe vazhdon të ushtrojë detyrën e gjyqtarit, apo jo?

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë jam dakord me mendimin e zotit Qoku sepse statusi, pasja apo jo e statusit të gjyqtarit lidhet me rrethana ligjore dhe jo me situata faktike që mund të ndodhin më pas. Me mbushjen e moshës 65 vjeç, gjyqtarit i mbaron statusi sepse kjo është një rrethanë ligji. Tani, fakti që ligji nuk e parashikonte mbushjen e moshës 65 vjeç por parashikonte arritjen e moshës për pension është një interpretim që ne e kemi bërë dhe një qëndrim që kemi mbajtur kur kemi nxjerrë gjyqtarë të tjerë në pension nga kjo periudhë, pra nuk mund të vendosim në situata pabarazie dy magjistratë në gjendje juridike të njëjtë. Kemi nxjerrë në pension kryetarin e Gjykatës së Dibrës, nëse më kujtohet, pikërisht për këtë shkak sepse kishte mbushur 65 vjeç. Tani nuk është çështje kërkesë apo bile ka edhe një detyrim që duhet ai të njoftojë paraprakisht Këshillin, gjyqtari, për mbushjen e moshës.

Fakti që ka vazhduar marrëdhëniet e punës, kjo është një marrëdhënie midis punëdhënësit dhe punëmarrësit por jo që i jep atij statusin e gjyqtarit. Prandaj edhe unë jam dakord me pikën e parë, që ai e ka patur statusin e magjistratit por ai e ka humbur për shkak të mbushjes së moshës për dalje në pension dhe vendimi i Këshillit që deklaroi mbarimin e statusit është një vendim deklarativ që edhe po nuk e more brenda afatit nuk do të thotë që atij i jep statusin.

Naureda Llagami: Atëherë, të hedhim si fillim propozimin e Komisionit sipas të cilit tek pika e parë diskutohet, pika e parë është: Deklarimi i pasjes së statusit të magjistratit zotit {...} dhe, në pikën e dytë është: Të deklarojmë mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për pension?

Si e keni pikën e dytë?

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat. Zoti Muharremaj pyet pa ndezur mikrofonin nëse propozimi që po hidhet në votim është propozimi i zotit Qoku. Hidhet në votim propozimi i zotit Qoku.)

Pra, deklarimin e mbarimit të statusit për shkak të - jo i Komisionit - për shkak të mbushjes së moshës për pension të inspektorit {...}.

Po! Kalojmë në votim këtë?

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalojmë te propozimi i bërë nga Komisioni, që ka të bëjë me deklarin e pasjes së statusit të magjistratit, zotit {...}. Zoti {...} vijon komandimin në detyrë si nëpunës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqësorit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në një vendimmarrje të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Si e latë?

Naureda Llagami: “Deri në një vendimmarrje tjetër të KLGJ-së”.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Atëherë, të më falni Kryetare, përpara se të hidhet në votim unë propozoj që shprehja nuk duhet të lidhet “deri në marrjen e një vendimi nga KLGJ-ja”, thjesht vijimin e detyrës, -si e kemi bërë formulimin për të tjerët, -lejimin, por jo me shprehjen “deri në një vendimmarrje tjetër”. Pra unë jam kundër shprehjes “deri në një vendimmarrje tjetër”, se është pa lidhje.

Po mirë, pra bëj një propozim tjetër sepse s’kam si të votoj unë.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Bardhi do vazhdojë derisa t’i mbarojë mandati ligjor nëse nuk mbush moshën për pension.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Po dakord pra, s’kemi pse ta themi ne. Edhe një herë të lutem, arsyjeja...

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Dakord pra, atëherë është në mandatin e dytë, që do të thotë, ai ligjërisht edhe sikur të dojë edhe në qoftë se s'e ka mbushur moshën për pension, 67-vjeç, siç u vendos tani, në momentin që do bëjë 10 vjet i komanduar ai nuk është më në Këshill.

Marçela Shehu: Pra 10-vjeçari nuk është rregull, pra ai 5 vjet mund të jetë i komanduar, ka marrë një komandim të dytë, por që mund të ndërpritet nga Këshilli nëse do ta vlerësojë.

Brunilda Kadi: Por s'i ka bërë 10 vjet.

Marçela Shehu: Nuk i ka bërë 10 pra.

Këshilli mund ta vlerësojë dhe mund ta ndërpresë komandatin e dytë, prandaj themi “deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit”.

Brunilda Kadi: Është e panevojshme që të themi këtë shprehje. Në qoftë se e bën, e bën, ai do vijojë sipas ligjit. Pse duhet ta themi ne në vendim? Këtë po pyes unë. Ku është ideja? Ai, më fal një sekondë, a është i ligjshëm ky propozimi, domethënë sipas propozimit, a është e ligjshme që ai të vijojë?

(Zonja Shehu përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)

Marçela Shehu: Jo!

Brunilda Kadi: Pse?

Marçela Shehu: Pra, pas përfundimit të komandimit të parë pesëvjeçar, ai nuk mund të vazhdojë të qëndrojë i komanduar për një periudhë tjetër 5-vjeçare, por duhet të punojë 5 vjet sipas ligjit aktual në gjykatë dhe më pas mund të komandohet përsëri dhe në total 10 vjet. Pra ligji nuk parashikon një komandim 10-vjeçar total. Më kupton?

Brunilda Kadi: Për inspektorët pra ai është i ligjshëm të vazhdojë të njëpasnjëshme, komandimin.

Marçela Shehu: Për inspektorët e ILD-së, jo për inspektorët e vlerësimit. Afati 10-vjeçar i komandimit nuk mund të jetë i njëpasnjëshëm.

Brunilda Kadi: Okej! Atëherë kjo është ideja, përtej kësaj që po thoni. Okej!

Marçela Shehu: Po!

Naureda Llagami: Atëherë, e hedhim edhe një herë në votim propozimin e bërë nga Komisioni. Vazhdo, zoti Maksi!

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër. Me arsyetimin që Këshilli duhet të deklaronte mbarimin e statusit sepse ka mbushur moshën për pension para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Kalojmë te çështja tjetër. Atëherë fjalën ia jap prapë zotit Bici për relatimin e rasteve të tjera.

Medi Bici: Tani, nëse tek magjistratët që erdhën nga gjyqësori ne ishim dakord me njeri-tjetrin, këtu kemi tre qëndrime të ndryshme për inspektorët jomagjistratë, por para se të kalojmë në votimin e çdonjërit prej tyre, do t'i kërkoja, Këshilli ka bërë, thotë që duhet të diskutohet problemi i {...}, për arsye se çështja e saj është në Kolegjin e Apelimit dhe ajo duke qenë një 'kuazi' gjykatë mendoj që ne nuk mund të arrijmë në shqyrtim pa...

Gjithashtu, ka një propozim nga zonja Fatmirë, që në bazë të ligjit për Statusin ajo i takon të rrijë në detyrë deri në momentin që të emërohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Dhe mendimi im është që meqenëse inspektorë të tjerë janë në të njëjtën situatë, ata kanë paraqitur dokumentet pranë KPK-së, si zonja {...}, pra si Kryeinspektorja, por për ato nuk është shprehur, mendoj, do të doja që të merresh një vendimmarrje për këto, qoftë edhe negative, nëse ne mund t'i hyjmë ose jo shqyrtimit për këto dhe pasi të vendosim, të kalojmë për secilin emër.

Propozimi konkret pra, që për zonjën {...} të mos shprehemi, mos e marrim fare në shqyrtim, për shkak, për dy arsye, edhe sepse çështja e saj është në Kolegjin e Apelimit dhe për shkak që në bazë të ligjit për Statusin ajo duhet të rrijë në detyrë derisa të emërohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Tek ajo që tha zoti Bici, brenda në fakt nuk konsiston në të njëjtin drejtim. Një propozim i juaji ishte që të pezullohet, me sa kuptoj unë, derisa të shqyrtohet çështja e zonjës {...} në Komisionin e Posaçëm të Apelimit dhe krahas kësaj çështjes së zonjës {...} dhe çështjet e inspektorëve të tjerë. Kështu ishte?

Propozimi i dytë nuk ka të bëjë me pezullimin. Propozimi i dytë është që Këshilli mos të shprehet fare, pra mos ta shqyrtojë fare statusin e kanë apo s'e kanë. Këto janë të ndryshme. Ne do duhet t'i votojmë të dyja një nga një, pavarësisht se ju e argumentuat se konsistojnë në një drejtim të dyja propozimet, por në fakt janë të dy të ndryshme, sipas meje.

Naureda Llagami: Mendoni që do kalojë në votim propozimin e parë që të bëhet pezullimi për shqyrtimin vetëm të...

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Fatmira Luli: Propozimi im është që të mos shqyrtohet, të mos jetë objekt vetëm për {...}, për shkak se Komisioni...

Po, për këtë shkak. Vetëm se është Kryeinspektore s'është objekt i këtij Komisioni dhe për shkak se ligji i ka caktuar një pozitë të veçantë. Jo të pezullohet. Të mos jetë objekt i shqyrtimit. Ky është propozimi.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në votim të propozimit të bërë nga anëtarja e Komisionit zonja Luli, lidhur me subjektin {...}, e cila, çështja e statusit për këtë subjekt mos të merret në shqyrtim nga ana e Këshillit, për shkak se ajo është në pozicionin e Kryeinspektore së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Medi Bici: (*Propozimi i zotit Bici*) ...pezullimin, pra e shqyrtimit të çështjes për {...}, për shkak të apelimit të saj, nga ana e saj të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vendimin nr. 115, datë 11.03.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ilir Toska: Është për të gjithë inspektorët apo vetëm për...?

Por nëse do duhet të procedojmë për të gjithë i bie të marrim për secilin, pra nëse biem dakord, o të vazhdojmë o të pezullojmë, të biem dakord për të gjithë. Se nuk jemi racional ashtu. Domethënë nëse ju keni të njëjtën kërkesë për të gjithë inspektorët e tjerë, konsiderojeni për të gjithë të tjerët.

Medi Bici: Për inspektorët e tjerë është propozimi im.

Ilir Toska: Ju ngaqë e thatë pra. Ngaqë thatë që kanë të njëjtin ngërç si zonja {...}. Atëherë, kërkesa juaj për pezullimin është për të gjithë apo vetëm për zonjën {...}?

Medi Bici: Vetëm për {...}.

Ilir Toska: Okej!

Naureda Llagami: Po!

Brunilda Kadi: Kam një pyetje për kryetarin e Komisionit. Ku bazohet ky propozimi që duhet të pezullohet sepse të gjithë deri tani jemi shprehur dhe vlerësuar dhe unë e besoj përderisa e kam votuar, që organi kushtetues, i vetmi në Republikën e Shqipërisë, që përcakton statusin e magjistratit është Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorët. Arsyeja dhe baza ligjore që neve duhet të pezullojmë që të shprehet një organ tjetër, cilido qoftë ai, duke patur parasysh këtu që vendimi për këtë subjekt është dhënë nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, i cili dihet sipas gjithë legjislacionit shqiptar, e të gjithë e pranojmë, që nuk është një gjykatë, është organ administrativ. Ndërkohë ankimimi në Këshillin e Posaçëm të Apelit i cili është gjykatë, është aneks i Gjykatës Kushtetuese është bërë mbi bazën e ankimit të vetë subjektit. Cila është baza ligjore që ne duhet të presim një organ tjetër të cilin e pranojmë që s'e ka kompetencë të shprehet për statusin, që ne të pezullojmë për t'u shprehur për këtë detyrim ligjor që kemi, përderisa e krijuam dhe Komisionin dhe e bëmë dhe me magjistratët e tjerë. Bazën ligjore dhe arsyetimin.

Medi Bici: Pra është parim, kur çështja shqyrtohet nga një gjykatë tjetër, nuk mund të shqyrtohet nga organe të tjera administrative.

Brunilda Kadi: Një pyetje tjetër. Nëse, ne u shprehëm për magjistratët një pjesë të tyre dhe thamë që kundër këtij vendimi lejohet ankimi, dhe nuk u shkrua se ku lejohet ankimi. Në lidhje me themelin, me meritat e asaj që vendosëm, a kanë të drejtë magjistratët ta ankimojnë këtë vendim, dhe nëse po ku e ankimojnë, që të interpretojmë invers, në të kundërt, pra që ne duhet të presim a ka një organ më të lartë se sa ne që përcakton statusin dhe që neve s'ka kuptim të shprehemi përderisa ky organ e ka në shqyrtim këtë çështje? A ka një organ? Cili është organi që ne na e rrëzon vendimmarrjen, kur themi për një subjekt që ka apo s'ka statusin e magjistratit, ka një organ të tillë?

Medi Bici: Unë e dhashë përgjigjen, shkakun pse e kërkoja pezullimin.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Unë jam dakord me propozimin që bën zoti Bici, për pezullimin, për sa kohë çështja e zonjës {...}, e cila në fakt ka të bëjë me procesin e rivlerësimit të saj, por që në këtë proces Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka konsideruar të vejë në diskutim çështjen e statusit të zonjës {...}, dhe tashme kjo çështje ndodhet përpara dhomës së dytë të Gjykatës Kushtetuese. Referuar kodit të procedurës civile, nuk mundet një institucion i administratës publike të marrë në shqyrtim një çështje që ndodhet në shqyrtim përpara një gjykate. Jemi para... ta lexoj deri në fund? Mund ta lexosh edhe ti se nuk është ndonjë problem, por po ta lexoj. “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”. Kështu është e formuluar.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Ku kemi mosmarrëveshje ne?! S'ka lidhje mosmarrëveshjeje këtu.

Ilir Toska: A mund ta mbaroj? Ti mund të thuash tënden Bruna, por mos ndërhy tek të gjithë, se nuk është komode kështu që të vazhdosh të bësh debat.

Unë kështu e mendoj gjënë. Fakti që Këshilli është organi që verifikon statusin, e kam thënë në çdo mbledhje që është diskutuar kjo gjë. Por ne nuk mund të zhbëjmë faktin që Komisioni Pavarur i Kualifikimit ka vënë në diskutim pikërisht këtë çështje dhe

pikërisht kjo çështje është tashmë përpara dhomës së dytë të Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pikërisht dispozita që sapo citoi kolegu është ajo që ne na pengon për të pasur këtë arsytim sepse nuk bëhet fjalë për mosmarrëveshje, bëhet fjalë për një kompetencë kushtetuese që ne e pranuar me vendimmarrjen që sapo kemi bërë deri tani që e kemi ne kompetencë kushtetuese për t'u shprehur për statusin. Kështu që, kjo nuk është një mosmarrëveshje civile që ne duhet të presim një gjykatë që të shprehemi. Plus, thashë, objekti aty nuk është statusi i subjektit por është të kalojë apo jo procesin e rivlerësimit. Ky është objekti.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Duke qenë se unë vetë si anëtare kam mbajtur një qëndrim të mëparshëm tek çështja {...}, lidhur me... rasti nuk është analog, por edhe aty kompetencën për të vendosur deklarin e mbarimit të statusit apo në rastin konkret të pasjes së statusit, e ka pasur Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështja ka qenë para edhe ajo para juridiksionit kushtetues sepse është dhomë e veçantë e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë shkak jam e mendimit dhe bashkoj mendimin e zotit Toska dhe Bici që Këshilli duhet ta pezullojë shqyrtimin e kësaj çështjeje deri në shprehjen e Gjykatës Kushtetuese, për faktin se pavarësisht rezultatit final që kërkohet të realizohet nëpërmjet ankimit, objekt i shqyrtimit të këtij juridiksioni është edhe fakti i pasjes ose mospasjes së statusit të gjyqtarit që e lidh pastaj me konsekuencat e tjera të një ligji të posaçëm.

Për shkak se vendimet gjyqësore, pavarësisht, sidomos vendimet e Gjykatës Kushtetuese, përfundimisht do të përbëjnë gjë të gjykuar jo vetëm për dispozitivin por edhe për rrethana fakti që i kanë shërbyer atij arsytimi, mendoj që ka një koneksitet dhe lidhje patjetër midis marrjes sot ne të një vendimi për pasjen apo jo të statusit me vijueshmërinë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhomë e veçantë e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, jam dakord edhe unë me pezullimin, por jo për shkak se nuk e ka kompetencë kushtetuese Këshilli.

Brunilda Kadi: Meqenëse në rastin e z. {...} edhe unë kam votuar njëjloj si kolegia, arsytimi im ka qenë i ndryshëm dhe ka pasur lidhje me momentin procedural kur është paraqitur sepse ishte rast dorëheqjeje; kur e kishte të drejtë, kur s'e kishte të

drejtë; faza në të cilën ndodhej. Kështu që, thjesht për të qenë koherent me atë që kam votuar më përpara.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni, lidhur me pezullimin e vlerësimit të statusit për znj. {...} pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, deri në një vendimmarrje nga Kolegji i Posaçëm të Apelimit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër, për të gjitha arsyet.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Kalojmë tek subjektet e tjera.

Medi Bici: Në të njëjtat kushte janë edhe këta, vetëm se nuk kanë vendime, vendimmarrje, por dokumentet i kanë paraqitur dhe do të doja që të shprehej Këshilli për këto, për të pestë.

Pezullimin e çështjes, shqyrtimin e çështjes edhe për inspektorët e tjerë juristë derisa të përfundojë shqyrtimi i çështjes për znj. {...} {...} nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Inspektorët {...}, {...}, {...}, {...}.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Dua të shpreh mendimin tim kundër. Nuk e kuptoj arsyetimin, fakti që ndodhen/janë subjekt rivlerësimi, janë për shkak të ligjit dhe Kushtetutës. Nuk ka asnjë vendimmarrje që të afektojë çështjen e statusit përpara ndonjë organi tjetër 'kuazi' gjyqësor apo para një organi gjyqësor. Kështu që, ne nuk kemi asnjë pengesë ligjore që të vijojmë të shqyrtojmë dhe të ushtrojmë kompetencat tona për statusin e të gjithë atyre që konsiderojmë që e kanë këtë status apo nuk e kanë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në votim propozimin e bërë nga z. Bici?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

(Vota e zotit Bici nuk dëgjohet.)

Naureda Llagami: Kundër.

Kalojmë me relativimin për secilin subjekt, për secilin ish-inspektor. Për {...}, kush do të bëjë relativimin e rrethanave të faktit dhe propozimet konkrete nga Komisioni?

Medi Bici: Anëtar i Komisionit, zoti Maksi.

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Mundohem t'i bie shkurt.

Në zbatim të nenit 62 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes” dhe nenit 168 të ligjit nr. 96 “Për statusin e gjyqtarëve” Këshilli me vendimin nr. 59 ngriti Komisionin e Përkohshëm. Inspektore {...} ka lindur në Durrës me datë 28.03.1963 dhe është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë në programin kurs i përshpejtuar, vitet akademike ‘93-‘94. Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 13, datë 24.11.1993 dhe më pas transferohet po si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 01, datë 30.03.1995. Është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 07, datë 08.02.1996 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Znj. {...} është shkarkuar nga detyra e gjyqtares, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 28/1, datë 20.03.1999 me motivacionin: “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”. Gjatë periudhës 1999-2003 ka punuar në profesionin e lirë të avokates, pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe më pas është emëruar si specialiste finance në Sektorin e Prokurimeve Publike, pranë Presidencës së

Republikës së Shqipërisë. Me vendimin nr. 312, datë 18.03.2013 të ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë, duke u bazuar në ligjin nr. 8811 datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar dhe me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë” i miratuar me vendim nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, të po këtij Këshilli, ka emëruar znj. {...} në detyrën e inspektore, ndërsa me vendimin nr. 36, datë 07.05.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë asaj i është zgjatur mandati inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në bazë të Urdhrit nr. 08, datë 19.04.2013 të ish-titullarit të KLD-së mbi ndarjen e Inspektoratit të Këshillit të Lartë në seksione, znj. {...} ka mbuluar Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik, në procesin e shqyrtimit të vendimeve të cenuara nga gjykatat e niveleve më të larta dhe Seksioni i Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave. Ndërsa prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 3/10 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve” është parashikuar se organi i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka funksionuar sipas ligjit 8811 të datës 2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit”, prandaj Komisioni i Përkohshëm është i mendimit që kjo detyrë duhet të vazhdojë të kryhet nga një strukturë e specializuar.

Sugjerimet për inspektorët janë bërë duke u bazuar në nenet 14, 15 të ligjit nr. 8811 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar neni 168 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, i ndryshuar si dhe 115/2016 “Për organet e qeverisjes e drejtësi”, pasi vazhdimësia institucionale, mënyra e interpretimit ligjor dhe vendimmarrja e KLGJ-së krijojnë një precedent në shqyrtimin e rasteve të ngjashme, konkretisht në lidhje me pozicionin, statusin e Inspektorëve në detyrë.

Propozimet që vijnë për znj. {...} nga Komisioni i Përkohshëm arsyetojnë sipas këndvështrimit ligjor ku, znj. {...} nuk e gëzon statusin gjyqtarit, pasi është emëruar në detyrën e inspektorit me vendim nr. 312, datës 2013 në bazë në ligjin nr. 8811 të 2001, i ndryshuar, nëse i referohemi nenit 14/3 dhe 15/2 ligji përcakton se inspektorë të marrë nga radhët e juristëve iu njihen benefitet për efekt të pagës dhe vjetërsisë në punë të

barasvlershme me atë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, por kjo nuk u jep statusin e gjyqtarit.

Po t'i referohemi të njëjtit nen, pra 15, paragrafi 2, shprehimisht thuhet: gjyqtarët që shërbejnë si inspektorë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs dhe znj. {...} nuk është në kushtet e statusit të gjyqtarit pasi ka ardhur nga radha e juristëve si inspektore dhe nuk i është nënshtruar provimit pranë të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar gjithashtu në nenin 28 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në fuqi, në kohën kur znj. {...} është emëruar inspektorë, specifikohet se, gjyqtarët me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmësligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati gjyqtarët kthehen në vendet e mëparshme të punës, ku përsëri znj. {...} nuk është në këto kushte, pasi emërimi si gjyqtar duhej të bëhej bazuar në nenin 11 dhe nenin 12/1 të ligjit 9877, datë 18.02.2008, gjyqtari në Gjykatën e Shkollës së Parë dhe Gjykatën e Apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërim të cilin znj. {...} nuk e ka marrë gjatë punës si inspektorë, pra për pasojë jemi para faktik që znj. {...} nuk mund të përmbushte kushtet për t'u emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit, pasi nuk gëzonte statusin e gjyqtarit.

Tani në lidhje me sa propozojmë, unë si anëtar Komisioni kam propozimin tim, pasi ne ndahemi.

Sipas propozimit tim, bazuar në nenin 165/4 të ligjit 96/2016 znj. {...} t'i nënshtrohet një testimi profesional në Shkollën e Magjistraturës dhe pas kalimit me sukses të testimit, të ndjekë një vit programi tek Shkolla e Magjistraturës dhe një vit praktikë profesionale. Dhe pika 2, bazuar në nenin 165/9 të ligjit 96/2016 propozohet për t'u emëruar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor apo nëpunës civil në sistemin e prokurorisë nëse ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Kjo është për sa i përket relacionit, pastaj në lidhje me propozimin bëjmë dhe votimin. Faleminderit!

Medi Bici: Zonja Kryetare, meqenëse unë kam pikëpamje dhe mbroj variantin e tretë, për të mos e marrë fjalën dy herë, po jap qëndrimin tim për të dy variantet, për variantin që shprehur z.Maksi dhe qëndrimin tjetër që mban dhe anëtarja tjetër.

Gjatë punës në Komisionin e Përkohshëm ne anëtarët e tij nuk kemi qëndrime të ndryshme për sa i përket inspektorëve të ardhur direkt nga gjykatat e rretheve gjyqësore në lidhje me pasjen e statusit të magjistratit, ndërsa për inspektorët e ardhur nga rrethi i juristëve, të cilët plotësonin kriteret për të qenë gjyqtar apeli, mendimet e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm kanë qenë të ndryshme.

Për të sqaruar nëse kanë ose jo statusin e gjyqtarit, inspektorët juristë, dhe nëse e kanë, në bazë të cilit ligj e kanë fituar këtë status, shkurtimisht po parashtoj qëndrimin tim si më poshtë:

Neni 4 i ligjit 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” parashikon se: “3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë; Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë. Për vendet vakante në niveleve drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs; Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë; Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.”

Ndërsa në nenin 28 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, në administratën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e

Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës; Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave; Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesionin gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale; Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

Njëri prej qëndrimeve në Komisionin e Përkohshëm ka qenë se ruajtja e statusit të gjyqtarëve nga inspektorët {...} dhe {...} bazohet pikërisht në këto dy ligje, i cili për mendimin tim është një qëndrim i pabazuar në ligj sepse emërimi i inspektorëve aktual në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë është bërë me ligj të posaçëm, i cili është ligji 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar. Është parim i njohur i të drejtës se, kur ka një ligj të posaçëm për rregullimin e një marrëdhënieje juridike, ligji i zbatueshëm është ky i fundit. Ndërsa vetëm për çështjet që nuk rregullon ai, mund t’u drejtohesh ligjeve të tjera ose dispozitave të tjera të përgjithshme të të drejtës. Gjithashtu rezulton që inspektorja {...} është emëruar si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 15.05.2000, pra shumë kohë përpara se të miratoheshin ligjet për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe organizimit të pushtetit gjyqësor. Prandaj këto dy ligje nuk mund të zbatohen në këtë rast sepse ato nuk kanë fuqi retroaktive.

Inspektorja {...} është emëruar në Ministrinë e Drejtësisë me datë 19.03.2003, prandaj ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, që është miratuar në vitin 2008 nuk gjen zbatim edhe për këtë rast, për shkak se ai nuk ka fuqi prapavepruese.

Neni 4 i ligjit 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” parashikon se: “Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë; Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.”

Pra sipas kësaj dispozite ligjore, Ministri i Drejtësisë, duhej t'i drejtohej me kërkesë ish-KLD-së, i cili duhet të jepte pëlqimin për emërimin e gjyqtarit në Ministri. Në dosje të inspektorëve që kanë punuar në Ministrinë e Drejtësisë, nuk gjendet asnjë kërkesë e Ministrit të Drejtësisë, drejtuar ish-KLD-së dhe pëlqimin e këtij të fundit për emërimet pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sipas këtij ligji, gjyqtari i emëruar në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tij, mund të riemërohej gjyqtar pa konkurs dhe jo të kalonte inspektor, duke humbur përfundimisht të drejtën për t'u bërë gjyqtar sipas kësaj dispozite ligjore të parashikuar në ligjin “Për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

Në ndryshim sa thashë më sipër, në vlerësimin tim është se inspektorët ish-gjyqtar e kanë patur statusin e gjyqtarit të apelit që në momentin që ato janë emëruar si inspektorë pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, jo duke u bazuar në ligjet që shtova më sipër, por duke u bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar i cili është ligji i posaçëm që rregullon këtë marrëdhënie juridike konkrete.

Për të mbështetur qëndrimin tim, më duhet të kthehem shumë mbrapa në kohë, duke vënë në pah parashikimet që bënte legjislacioni ynë në lidhje me çështjet e magjistratëve dhe të inspektorëve të ish-KLD.

Në Republikën e Shqipërisë termi ‘magjistrat’ u përdorur për herë të parë në nenin 25 të ligjit nr.8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i pa ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi me datë 15.09.1996.

Në nenin 23 të ligjit të mësipërm është parashikuar se, gjyqtarët dhe prokurorët që kanë mbushur 5 vjet në punë, dhe që nuk kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës i nënshtrohen veprimtarive të vazhdueshme për formimin plotësues. Periudha e formimit, nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj në vit dhe kurdoherë jo më shumë se 3 muaj gjithsej gjatë 5 vjetëve. Pjesëmarrja e magjistratëve në veprimtarinë e formimit plotësues është detyruese.

Ndërsa neni 25 i po këtij ligji thotë se: “Gjyqtarët, prokurorët, dhe juristët që marrin pjesë në veprimtarinë e formimit plotësues, si dhe në kurset perfeksionimit, në mbarim të tyre, pajisen me certifikatë të posaçme të lëshuar nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës. Certifikatat futen në dosje dhe dëshmojnë për kualifikimin e magjistratëve.

Në kuptim të këtij ligji rezulton se inspektorët {...} dhe {...} janë emëruar në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Rrethit Gjyqësor Korçë në vitin '93, ndërsa inspektorja {...} është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në vitin 1994. Pra ato janë emëruar gjyqtarë përpara se të hynte në fuqi ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, por akoma nuk kishin mbushur 5 vjet në detyrë, prandaj ishin të detyruar t’i nënshtroheshin trajnimit vazhdues dhe të pajiseshin me certifikatë, që vërtetonin trajnimin e magjistratit.

Inspektorja {...} është emëruar në Gjykatën e Rrethit Dibër në vitin 1983 dhe ka qëndruar në këtë detyrë për më shumë se 10 vjet. Pra në kohën kur ka hyrë në fuqi ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, ajo nuk ishte në detyrën e gjyqtarës dhe kishte mbi 5 vjet vjetërsinë si gjyqtare, prandaj edhe sikur të vazhdonte të ishte në sistemin e drejtësisë, sipas ligjit “Për Shkollës së Magjistraturës” të pa ndryshuar, ajo nuk i nënshtrohej trajnimit vazhdues duke u konsideruar magjistrate.

Inspektorja {...} është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramash ne vitin '91, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 2000 kohë kur është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.

Pra në kohën e miratimit të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës”, edhe kjo gjyqtare ka qenë magjistrate.

Në nenin 17 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1996 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, të pandryshuar, është parashikuar se: “Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet Inspektorati. Këshilli i Lartë i Drejtësisë emëron inspektorët. Inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohen juristët që plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtar apeli. Ata barazohen në pagë dhe në të drejta me gjyqtarët e apelit.

Me ligjin nr.8546, datë 05.11.99 janë bërë ndryshimet në nenin 17 të ligjit të mësipërm, vetëm për sa i përket kompetencës së emërimit dhe shkarkimit të inspektorëve, i cili nuk bëhej më nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, por nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, etj.

Pra ky ligj bënte fjalë për juristë që plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë apeli dhe nuk bën asnjë dallim ndërmjet gjyqtarëve në detyrë dhe ish-gjyqtarëve, që do të thotë se vendoste barazi të plotë ndërmjet tyre.

Ligji nr.8436, datë 28.12.96 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar, është shfuqizuar nga ligji 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Duke filluar nga mesi i vitit 2001 rekrutimi i inspektorëve në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, nuk behej më duke u bazuar në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, por duke u bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, i cili parashikonte: “Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet; Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale; Gjyqtarët që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre rëmërohen gjyqtarë pa konkurs.”

Po të shihen me kujdes dy ligjet që cituam më sipër, që kanë të bëjnë me rekrutimin e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë në periudha të ndryshme, del mjaft qartë se ato nuk kanë ndryshime thelbësore me njëri-tjetrin, për sa i përket kushteve për emërimin e juristëve të cilët duhet të plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë apeli dhe koha që ata punojnë në Inspektorat pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë u njihet për efekt karriere dhe vjetërsie në punë si gjyqtar apeli, që do të thotë që në momentin e daljes në pension, organet e sigurimeve shoqërore ua njohin vjetërsinë e punës si inspektor dhe ua paguajnë pensionin suplementar sikur ishin gjyqtarë apeli, dhe jo si gjithë juristët e tjerë, të cilët nuk kishin asnjë mundësi që të konkurronin për t’u bërë inspektorë pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ligji “Për funksionimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” parashikon se gjyqtarët që shërbejnë inspektorë, rëmërohen gjyqtarë, me kërkesë të tyre.

Praktika shumëvjeçare që është ndjekur në vendin tonë nuk ka bërë dallime ndërmjet gjyqtarëve në detyrë dhe ish-gjyqtarëve, pasi ka shumë raste që ish-gjyqtarët e ardhur nga radhët e juristëve, që kanë shërbyer si inspektorë pranë ish-KLD-së, sot janë bërë gjyqtarë në gjykatat e apeleve dhe të rretheve gjyqësore.

Ligji 8436 datë 28.12.1996 ‘Për organizimin e pushtetit gjyqësor’, i ndryshuar me ligjin 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, në asnjë dispozitë të

tyre nuk bëjnë fjalë për humbjen e statusit të gjyqtarit. Gjyqtari edhe pasi largohet nga detyra, e ruante këtë status, ashtu siç e ruajnë shumë shtresa të tjera të popullsisë në vendin tonë, si oficerët, minatorët, naftëtarët, etj.

Për herë të parë në legjislacionin tonë, mbarimi i statusit të magjistratit, është parashikuar në kreun e 7 të ligjit 96/2016 “Për statusin e magjistratit”, i cili për mendimin tim përbën një hap të vogël prapa në lidhje me statusin e magjistratit, pasi gjyqtari mund të largohet nga detyra, për rastet e parashikuara në ligj ose mund të dalë në pension kur mbush moshën për pension pleqërie, por atij nuk mund t’i hiqet titulli i juristit apo magjistrat, pasi këto janë të drejta të fituara dhe të mbrojtura në nivel kushtetues.

Është e vërtetë që në nenin 165 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e magjistratit”, bëhet fjalë për inspektorë që nuk e kanë statusin e magjistratit në ish-KLD. Por ky ligj nuk mund të marrë përsipër që të rregullojë një marrëdhënie juridike, të rregulluar 15 vjet më parë nga ligji nr.8811 “Për organizimin dhe funksionimin e ish-KLD” sepse ai nuk ka fuqi prapavepruese.

Nëse do të ekzistonte vullneti i ligjvënësit, për të bërë një ndarje të tillë, ndërmjet inspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve” duhet ta bënte vetë një ndarje të tillë, duke përcaktuar se cilët inspektorë e kanë dhe cilët inspektorë nuk e kanë statusin e magjistratit, prandaj për të përcaktuar këtë status, ne si Këshill jemi të detyruar që të referojmë vetëm në parashikimet që bën ligji 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i cili ka qenë ligji i vetëm në fuqi me të cilin janë rekrutuar të gjithë inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Duke arsyetuar në këtë mënyrë, vlerësimi im përfundimtar është se të gjithë juristët që kanë ardhur në detyrën e inspektorit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke plotësuar kriteret për të qenë gjyqtar apeli, e kanë statusin e gjyqtarit të apelit që në momentin e emërimit në detyrën e inspektorit pranë ish-KLD-së, duke u bazuar në ligjin 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, prandaj të gjithë ato duhen të konsiderohen magjistratë dhe në bazë ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” duhet t’u konfirmohet statusi i magjistratit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Zonja Luli!

Fatmira Luli: Të japë edhe unë mendimin tim në lidhje me diferencën që kam... Ndahemi me mendime.

Naureda Llagami: Pra, ne në fakt, që në fillim të mbledhjes thashë, që ne do t'i trajtojmë çështjet individualisht dhe ju mendimet do t'i kishit individualisht. Por nuk doja të ndërprisja zotin Bici tani në trajtimin tërësor.

Pra nëse zoti Qoku foli fillimisht për {...} Zhillën, zoti Bici duhet të vazhdonte prapë për {...} Zhillën dhe ti prapë për {...} Zhillën, se nuk mund të presim këtu. Këto argumente i keni pasqyruar edhe tek raporti përmbledhës që e kemi ezauruar tek mbledhja e mëparshme.

Sot do flisnim individualisht për situatën faktike ligjore të secilit.

Medi Bici: Një minutë. Për sqarim.

Unë e thashë edhe në fillim të fjalës time, që mos ta marrë fjalën më.

Brikena Ukperaj: Pra, ti mendon që të gjithë janë magjistratë.

Medi Bici: Të gjithë janë magjistratë.

Fatmira Luli: Atëherë, mendimi im në Komision ka qenë që, {...} nuk e ka statusin e magjistratit sepse bazuar në nenin 14 të ligjit 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", pika 3, ajo ka ardhur në punë nga radhët e juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet .

Ligji, ky nen e bën diferencën midis gjyqtarëve që kanë punuar në gjykata, kandidaturat e inspektorëve për zgjidhjen pas shpalljes publike ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t'u emëruar gjyqtar në gjykatën e apelit dhe në mungesë të tyre ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet.

Kjo e bën diferencën midis dy kategorive, të nëpunësve, të gjyqtarëve dhe nëpunësve që kanë punuar në këtë funksion dhe që kush e ka statusin e kush nuk e ka.

Edhe kur bën fjalë në nenin 15 për të emëruar, për të punuar në gjykatë pas periudhës së komandimit, përsëri ligji në nenin 15, në pikën 2 e diferencon gjyqtarin, i cili ka shkuar si inspektor nga pjesa e juristëve që ka shkuar të punojë.

Për gjyqtarët që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs.

Kjo e drejtë nuk ushtrohet për ata që janë juristë, që kanë ardhur në punë jo si gjyqtarë. Kjo është për Sofien, në lidhje me statusin.

Lidhur me pasojat, gjykoj që {...} ka të drejtë të punojë si nëpunëse civile, jo si gjyqtare, në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose ku ta zgjedhë ajo, si nëpunës gjyqësor.

Të drejtat e tjera i ka sipas ligjit, nuk ka nevojë të shprehet Këshilli i Lartë Gjyqësor, se duhet të testohet në Shkollën e Magjistraturës apo të ndjekë kurse të tjera.

Them të shprehemi vetëm të konfirmojmë që ajo nuk e ka statusin e gjyqtarit dhe ajo mund të vijojë, ka të drejtë sepse ajo mund të mos e dëshirojë të vijojë. Ajo ka shprehur dëshirën të punojë vetëm me pagën e gjyqtarit, jo si nëpunës civil. Ajo ka të drejtë të vijojë punën si nëpunës civil në sektorin në Njësinë e Vlerësimit. Pastaj le ta çmoj vetë. Ky është propozimi im në Komision.

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, lidhur me zonjën {...}, unë mbështet mendimin që zonja {...} nuk e ka patur statusin e gjyqtarit dhe nuk e ka statusin e gjyqtarit qoftë në momentin e emërimit, qoftë pas ndryshimeve ligjore. Të pranosh që inspektori merr statusin e gjyqtarit, do të thotë që gjyqtar u bëke jo vetëm me dekret të Presidentit por dhe me vendim të Këshillit që të bën inspektor dhe kjo është e papranueshme se bie në kundërshtim me nenet 14, 15 të ligjit 2001 që ka qenë në fuqi në momentin e emërimit të inspektorit. Por edhe ligjet e mëpasshme të reformës ligji për Statusin dhe ligjet mbështetëse të tjera e kanë rregulluar statusin e inspektorëve jomagjistratë.

Ligji, në qoftë se ka pasur për qëllim që të gjithë inspektorët të kishin statusin e magjistratit, nuk kishte arsye që në dispozitat tranzitore të rregullonte statusin e inspektorëve magjistratë nga statusi i inspektorëve jomagjistratë. Pra vetë ligji i mëpasshëm e ka patur parasysh që nuk kanë të njëjtin status, jo të gjithë janë gjyqtarë, por ka nga ata që janë gjyqtarë dhe ka nga ata që janë jogjyqtarë. Kështu që, mjafton për të arritur në konkluzionin që në qoftë se nuk kanë ardhur nga anët e gjyqtarëve, a nuk e kanë statusin e gjyqtarit, dhe zonja {...} për mendimin tim nuk e ka statusin e gjyqtarit.

Lidhur me propozimin e zotit Maksi nëse ajo duhet të shkojë në shkollë apo jo, kjo i takon pastaj vijimit të marrëdhënies së punës si nëpunëse përgjegjëse e vlerësimit me statusin e nëpunësit civil dhe pastaj duhet parë nëse është e nevojshme apo jo për

efekt të mbajtjes së vendit të punës apo ka qenë thjesht një detyrim ligjor për efekt të procesit të rivlerësimit duke qenë se ajo është subjekt i rivlerësimit.

Kështu që, propozimi, jam dakord me zonjën Fatmira, që të deklarohet mospasja e statusit të magjistratit për zonjën {...} dhe ajo të vazhdojë detyrën si nëpunëse përgjegjëse e vlerësimit me statusin e nëpunësit civil ose nëse kjo nuk është e nevojshme të shprehet nga Këshilli, le ta vendosim.

Brunilda Kadi: Edhe unë jam dakord me atë që tha zonja Ukperaj, por me ndryshimin, megjithëse në fund e citoi më duket, unë mendoj që neve, në momentin kur Këshilli vendos që nuk ka status, disponimi jonë mbaron aty. Punësohet apo jo, vazhdon apo jo, mendoj që nuk është kompetencë e Këshillit. As që të shkojë tek Shkolla e Magjistraturës, as që të kalojë rivlerësimin, se nuk është kompetencë e jona, lidhet me vullnetin e saj dhe me kompetencat e organeve të tjera dhe vijimi i saj si nëpunëse civile në administratën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse e ka këtë të drejtë apo jo, kjo mendoj që është në kompetencat e Kryetarit të Këshillit dhe jo e Këshillit. Ne thjesht, në momentin që deklarojmë që nuk ka status, këtu mbaron disponimi jonë, sipas mendimit tim, dhe unë propozoj që të hidhet edhe ky propozim në votim, vetëm kaq, nëse Këshilli vendos që s'ka status. Në qoftë se ka status pastaj, kemi përgjegjësi dhe kompetenca të tjera.

Naureda Llagami: Atëherë, si do t'i hedhim në votim? Të fillojmë me propozimin e zotit Maksi, i cili shprehet që...

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Mirë! Kam dhe një merak tjetër lidhur me mënyrën e riformulimit sepse kemi mbajtur standardin “deklarimi i pasjes”. Tani do fillojmë të mbajmë standardin “deklarimi i mospasjes”? Në fakt, s' shkon fare. Ajo s'e ka pasur.

Atëherë, e hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Kadi: Deklarimin e mospasjes së statusit të magjistratit për zonjën {...}.

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Tani, kalimin në votim të propozimit të bërë nga zoti Qoku që përveç pikës së parë të ketë dhe një pikë të dytë ku thuhet që t'i nënshtrohet një testimi profesional.

Maksim Qoku: Sa për sqarim, duke qenë që në bazë të relacionit unë jam bazuar direkt në ligjin, në dy dispozitat që janë urdhëruese në situatën, pavarësisht se duket që ne jemi të vonuar, kam bërë këtë propozim. Por natyrisht jam për pikën e dytë që...

Testimin, domethënë e tërheq për faktin që mbetet në dëshirën e saj dhe jam për tek pika e dytë që bazuar në 165, pika 9 të 96/2016 propozohet për t'u emëruar në pozicionin nëpunës civil gjyqësor, nëpunës civil në sistemin e prokurorisë, nëse ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, -kështu thotë dispozita. Propozoj t'i shtohet pika e dytë.

Brunilda Kadi: Kundër.

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

Kalojmë në votim propozimin, megjithëse s'bën sens. Kështu që kalojmë tek çështja tjetër.

Kalojmë me {...}n?

Kush do ta relatojë?

Kryetar, kush do e relatojë? Maksim?

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Tani, nuk e di nëse do vlyente të zgjatesha sepse të gjitha materialet dhe për këtë inspektor ju i keni pasur. Parashtrimet e mia janë pak a shumë të së njëjtës natyrë. Pra unë konkludoj dhe këtu e ndaj veten nga anëtarët e Komisionit që nuk e ka statusin e magjistratit dhe jam dhe për pikën e dytë që të emërohet në një pozicion nëpunës civil.

(Disa nga anëtarët flasin që ai ka dhënë dorëheqjen)

Tani relacioni, duke qenë se ishte i mëparshëm në kohë dhe i bërë, u shoqërua në këto gjëra. Për sa ne nuk ishim shprehur për dorëheqjen, natyrisht që unë duhet t'i merrja në konsideratë propozimet e mia dhe i kalojmë në votim. Faleminderit!

Fatmira Luli: Propozimi im ka qenë i njëjtë me propozimin e Maksit që {...} nuk e ka statusin e gjyqtarit dhe meqenëse ai gjatë kësaj periudhe ka dhënë dorëheqjen, unë them që Këshilli i Lartë Gjyqësorë duhet të shprehet edhe për faktin që ai s'e ka statusin e magjistratit dhe mbarimin e mandatit, mbarimin e detyrës për shkak se ka dhënë dorëheqjen.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Atëherë unë s'jam dakord deri në fund me atë që sa tha zonja Luli sepse në momentin që Këshilli vendos në hipotezën që vendos që s'ka status, këtu mbaron kompetenca jonë dhe dorëheqjen e trajton një organ tjetër që mendoj që është e Kryetares. S'na takon ne si organ, si Këshill.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim me propozimin e bërë nga zoti Qoku për pikën e parë, ku të shprehemi lidhur me deklarinimin e mospasjes së statusit magjistrat për zotin {...}. Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Naureda Llagami: Vetëm për statusin.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Lidhur me propozimin e bërë nga zoti Qoku i cili thuhet që t'i propozohet për t'u emëruar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor ose nëpunës civil në sistemin e prokurorisë nëse ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit në situatën që zoti {...} nuk punon më pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor sepse ka dhënë dorëheqjen, -atëherë mendoni që do ta vazhdoni këtë lloj...?

Maksim Qoku: Tërhiqem.

Naureda Llagami: Tërhiqeni nga propozimi.

Kalojmë tek çështja tjetër. Bëhet fjalë për zonjën {...}. Kush do bëjë relatin e çështjes?

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Mos u trembni, nuk do zgjatem shumë.

Edhe për inspektoren {...} janë të njëjtat argumente, referuar në të njëjtën bazë ligjore dhe thjesht, unë në cilësinë e anëtarit të Komisionit kam qëndrimin tim në lidhje me faktin e mospasjes së statusit të magistratit dhe kam bërë dhe një... Po tërhiqem nga pikat e tjera për faktin që mbetemi vetëm tek.. Po, nuk e ka. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, ndonjë diskutim? Çfarë qëndrimi...?

Po, Fatmira!

Fatmira Luli: Unë kam mendim të ndryshëm nga zoti Maksi unë mendoj që zonja {...} e gëzon statusin e gjyqtarit për arsyet që do parashtroj më poshtë.

Shkurtimisht dua të tregoj ku ka punuar zonja {...} që të jetë në dijeninë e të gjithëve. Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1988, me kohë të plotë. Pas përfundimit të Fakultetit të Drejtësisë ka punuar si këshilltare ligjore në Gjykatën e Rrethit Dibër dhe më pas është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Dibër me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 5, datë 01.07.1994, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në 2003, ku me vendimin 137/7 të po këtij Këshilli është liruar nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj. Zonja {...} është emëruar inspektore në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor

në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, menjëherë pas lirimit me dorëheqje nga detyra e gjyqtares, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në 15.09.2010.

Me vendimin nr.268, datë 15.09.2010 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë duke u bazuar në ligjin 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar me rregulloren përkatëse, ajo është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa me vendimin 65, datë 27.05.2016 ka marrë dhe një mandat të dytë si inspektore, pozicion të cilin e mban aktualisht dhe sot.

Unë kam gjykuar që zonja... Ka punuar në vlerësimin profesional të gjyqtarëve gjatë gjithë kësaj kohe, në seksionin... Jo, ka mbuluar seksionin e inspektimit dhe ankesave dhe që nga muaji tetor i 2017 kryen detyrën e inspektore vlerësuese për vlerësimin profesional të gjyqtarëve në zbatim të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve”.

Unë kam dhënë opinionin tim që kjo inspektore e gëzon statusin e gjyqtarit bazuar në nenin 28 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet ruajtja e statusit të gjyqtarit për personat që shërbejnë në institucione të tjera dhe konkretisht, në pikën 1 parashikohet: Gjyqtarët me kërkesën e institucioneve dhe pëlqimin e tyre si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltari i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës Lartë, të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog, drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.

Periodha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Në pikën 4 përcaktohet: Periodha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion dhe për ato gjyqtarë të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra meqenëse zonja {...} ka qenë gjyqtare dhe ka punuar në këto organe para vitit 2008, ajo në 2003 është emëruar në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë dhe më pas në Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe për efekt të karrierës është konsideruar si gjyqtare sepse vendi i punës që ka punuar për efekt të karrierës profesionale dhe të pagës që e ka trajtuar si

gjqtar, ajo ka ardhur në këtë funksion me cilësinë e të qenit gjyqtare sepse e ka pas të drejtën nga ligji, kështu që për këtë shkak edhe gjatë kohës që ka punuar në Inspektorat, ajo e ka gëzuar statusin e gjyqtarit. Unë gjykoj që ajo e ka statusin e gjyqtarit. Ky është komenti im për këtë inspektore. Prandaj unë kërkoj, kam propozuar që ajo duhet të deklarohet që e ka statusin e magjistratit, të gjyqtarit dhe të vijoje punën, deri në krijimin e ILD-së, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është propozimi im.

Naureda Llagami: Më fal, vetëm një pyetje kisha unë sqaruese.

Gjatë gjithë kohës, karrierës së zonjës, a ka patur raste që ajo i është nënshtruar punësimit sipas rregullave të nëpunësit civil apo në çdo pozicion ka qenë e komanduar për shkak të statusit që ka pasur si gjyqtare?

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

2003-shin, '99-ën, ka hyrë ligji "Për nëpunësin civil" në fuqi.

Jo, jo, edhe një herë!

Gjatë gjithë kohës nga 2003-shi dhe në vazhdim, a ka pasur, në marrëdhëniet e saj i është nënshtruar ndonjëherë rregullave të punësimit të nëpunësit civil?

Fatmira Luli: Nuk e di këtë. Nuk e kam këtë informacion.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Di që ajo ka punuar inspektore edhe në Ministrinë e Drejtësisë dhe ka bërë kërkesë. Jo vetëm kaq, por edhe në 2012 ka bërë disa herë kërkesa.

(Ndizet mikrofoni nga zonja Luli.)

Ka bërë dhe kërkesa gjatë kohës që ka qenë dhe inspektore këtu, për të punuar gjyqtare. Ka kërkesë në 30.11.2012, në 2014, në 2016, kërkesa të cilat nuk janë marrë në shqyrtim, nuk janë pranuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Naureda Llagami: Në fakt unë do doja që të verifikohej kjo situata sepse kemi konvergimin e dy stativeve ligjore, kemi statusin e komandimit si gjyqtare dhe për shkak të qenit status gjyqtare është komanduar në shumë funksione në Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjitha, dhe më pas, nëse kemi një situatë që zonja ka shkuar dhe është punësuar dhe i është nënshtruar procesit të nëpunësit publik dhe të administratës publike, automatikisht ajo ka heq dorë nga statusi i gjyqtares. Kështu që kjo është në fakt një rrethanë që unë e konsideroj relevante, po që s'e shoh që...

Fatmira Luli: Ajo ka kryer vetëm një detyrë të inspektore në Ministrinë e Drejtësisë dhe për këtë funksion ligji i 2008 parashikon, ligji i organizimit të pushtetit gjyqësor, që ky funksion njihet për efekt të karrierës, vjetërsi në punë si gjyqtar dhe për efekt të pagës. Po kështu... Kështu që unë për këtë... veç për këtë rrethanë mendoj që ajo... Inspektore ka qenë. Pastaj ka punuar dy mandate si inspektore.

S'kishte komandim. Bëhet fjalë para 2008-ës kur ka filluar punë ajo. Nuk bëhej me komandim. Ajo ka dhënë dorëheqjen dhe pastaj.

Naureda Llagami: Unë do doja në fakt që ta sqaronim këtë situatë përpara se të shkonim në vendimmarrje.

Fatmira Luli: Është liruar në 19.03.2003 dhe me vendimin nr. 5 datë 01.07...

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Në 2003-shin është liruar nga detyra me kërkesë të saj. 19.03.2003.

Në Ministri pra ka filluar menjëherë. 15.09.2010. Deri në 2010-ën.

Menjëherë, -thotë, pas lirit.

S'ka fare ndërprerje. Në 2010-ën pastaj ka ardhur inspektore.

Naureda Llagami: Po! Për këtë çështje mund ta shtyjme.

T'i kërkojmë informacion Ministrisë së Drejtësisë nëse gjatë periudhës që ajo ka punuar pranë Ministrisë së Drejtësisë i është nënshtruar procesit të rekrutimit për strukturat që ajo ka marrë pjesë, ka kontribuar.

Propozimi im është që ta kalojmë në një mbledhje tjetër, pasi unë kërkoj informacion lidhur me këtë çështje. Maksi! Vetëm për çështjen e kësaj.

(Zoti Qoku dhe disa anëtarë flasin pa ndezur mikrofonin.)

Maksim Qoku: Unë e kam parë në një tjetër këndvështrim dhe... Nuk është i rëndësishëm sepse unë e kam parë në të tjera kushte. Dakord, në qoftë se ju e shtyni se kjo kërkesë është e juaja.

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Një nga anëtarët ka nevojë që të ketë një informacion shtesë. Je dakord që të shtyhet?

Maksim Qoku: Natyrisht, jam dakord.

Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

(Zonja Luli voton pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, kjo çështje kalon në mbledhjen tjetër. Vazhdojmë me relatimin e çështjes tjetër për zonjën {...} apo {...}, kë do filloni?

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare! Atëherë pa dashur dhe këtu të zgjatem, në lidhje me të njëjtat argumente pak a shumë si dhe inspektorët e mëparshëm që referova. Unë si anëtar i Komisionit kam bërë propozimin për mospasjen e statusit të magjistratit.

Fatmira Luli: Atëherë unë kam mendim të ndryshëm nga zoti Maksi dhe kam argumenta të njëjta njësoj si për zonjën {...}.

Edhe zonja, inspektorja {...} ka lindur në Gramsh në '68 dhe është diplomuar juriste në vitin '87-'91. Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 13.05.2000 ku me vendimin 83 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është lirohet nga detyra me kërkesën e saj si gjyqtare.

Më datë 15.05.2000 është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 01.03.2011. Më pas me 04.01.2012 është emëruar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si specialiste në Drejtorinë Juridike dhe me vendimin 129, datë 18.11.2016 është emëruar në detyrën e inspektore, detyrë të cilën e mban dhe aktualisht.

Ka kryer detyrën, në ndarjen e punës që ka bërë Kryeinspektori ka kryer detyrën e inspektorit për vlerësimin etiko-profesional, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrojë përsëri.

Unë kam menduar dhe kam propozuar që kjo inspektore e gëzon statusin e gjyqtarit për arsyen se mbas kalimit, mbas dorëheqjes që ka bërë si gjyqtare ka punuar

nga viti 2010-2011 si ndihmëse ligjore dhe pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit ajo ka ikur me kërkesën e saj nga funksioni i ndihmëses ligjore, në pritje të një emërimi, të kërkesave që ka drejtuar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kërkesat mbajnë datën 07.09.2011, 06.03.2012, 27.09.2012, 30.11.2012, 06.06.2013, 21.01.2016, 12.02.2016. Janë 7 kërkesa të bëra prej saj në kohë të ndryshme për të gjitha vendet vakante si gjyqtar, në gjykata të ndryshme të vendit, pas mbarimit të detyrës si ndihmëse ligjore, dhe megjithëse ka bërë kërkesa dhe për gjyqtare dhe për inspektore ajo është emëruar mbas mbarimit të mandatit në 2011, si specialiste në Drejtorinë Juridike të Këshillin të Lartë të Drejtësisë dhe vetëm në 2016 është emëruar si inspektore, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrojë.

Me të njëjtën argument si për zonjën {...} mendoj që, funksionet që ka ushtruar ajo mbas detyrës së gjyqtarit janë funksione që sipas nenit 28 të ligjit 9877 të 2008, e kanë gëzuar statusin e gjyqtarit për efekt të vjetërsisë dhe të karrierës në punë. Kështu që ajo e ka gëzuar këtë status. Nuk ka asnjë lloj ndërprerjeje në punën e saj, në punë private, veprimtari kohe e cila është verifikuar edhe është hetuar nga Komisioni dhe ka rezultuar që ajo ka qenë në pritje të vendimit të emërimit edhe si gjyqtare edhe si inspektore, vendime të cilët nuk u morën nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe ajo është punësuar aty ku ka marrë emërimin më në fund, në fillim si specialiste pastaj edhe si inspektore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Edhe vendi i specialistes në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sipas pikës 4 të nenit 28, parashikohet në vendet që për efekt të vjetërsisë në punë e parashikon statusin e gjyqtarit dhe për këto arsye kam dhënë mendimin, kam shfaqur mendimin që kjo inspektore e ka statusin e gjyqtarit dhe mund të vijojë punën në njësinë e vlerësimit etiko-profesional që ka ky Këshill i Lartë Gjyqësor. Dhe besoj që nuk është vetëm mendimi im, por është mendimi që, ka dhënë një kontribut shumë të madh dhe është një nga inspektoret më të afta dhe më të përgatitura për përgatitjen e raporteve të vlerësimit. Kështu që, gjykoj që duhet t'i shërbejë, të vazhdojë t'i shërbejë këtij Këshilli.

Medi Bici: Vetëm një minutë, sa për ta sqaruar kisha.

Tani, zonja {...} është emëruar si ndihmëse ligjore në Gjykatë të Lartë me 15 maj 2000. Ligjet ku bazohet pretendimi i zonjës Fatmira është miratuar më 14.05.2001, pra një vit më vonë, dhe tjetri 8 vjet më vonë.

Fatmira Luli: Ashtu është. Por ligji i 2008-ës, ashtu siç e citova unë thotë, e ka thënë në mënyrë të shprehur, periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ato gjyqtarë të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni para hyrjes në fuqi të këtij ligj, -i pra i ka dhënë vetë ligji efekt prapaveprues, i ka përfshirë në këtë status. Kështu që, referuar kësaj dispozite unë gjykoj që e ka statusin.

Brunilda Kadi: Atëherë për Komisionin, se nisur nga ato materialet që na janë vënë në dispozicion, unë nuk arrija dot ta nxirrja si fakt. Së pari, zonja, del në një periudhë 9-mujore, domethënë që s'ka qenë as e punësuar, as në aktivitet, ndërkohë thotë që ka marrë licencën, (sipas CV-së së saj) që ka marrë licencën e avokatit. Së pari, është verifikuar që të paktën këto 9 muaj që ka qenë e pa angazhuar e ka ushtruar apo jo, dhe kjo, pavarësisht pohimeve të saj, që ju mund ta keni pyetur dhe mund të ketë thënë jo, a ka një vërtetim nga organet tatimore që nuk e ka ushtruar? - e para;

Dhe e dyta, nisur dhe nga ajo pyetja që u bë nga kryetarja në lidhje me statusin e nëpunësit, zonja kur ka punuar në Këshill, ka pasur ndonjëherë status nëpunësi, është marrë ndonjëherë, derisa është emëruar si inspektore? Sepse gjatë kohës që ka qenë në Këshill ka punuar specialiste juriste dhe me çfarë statusi ka ndenjtur derisa është emëruar si inspektore?

Dhe pyetja e tretë është: Tek vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë thuhet shprehimisht nga vjen? Vjen nga gjyqësori apo vjen si jurist nga jashtë? Këto kisha si pyetje për t'u sqaruar.

Fatmira Luli: Atëherë lidhur me pyetjen e parë që ka deklaruar që ka marrë licencën si avokate. Këtë deklaram unë s'e kam ndeshur në asnjë vend në materialet e {...}t, që ajo ka deklaruar që ka marrë licencën si avokate.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Po kur ka qenë në punë, si licencë profesionale, jo licencë për ushtrimin, jo licencë të organeve tatimore.

Brunilda Kadi: Dakord pra, por meqenëse ka një periudhë 9-mujore pa punë.

E kuptova Mira, Fatmira.

Më fal, duke qenë se është një periudhë 9-mujore e pambuluar. Nuk ka qenë e angazhuar në punë.

Fatmira Luli: Po pra po. Është pyetur për këtë periudhë.

Brunilda Kadi: A ka vërtetime nga organet që merren me këtë punë që nuk e ka ushtruar?

Fatmira Luli: Ka bërë kërkesa.

Nuk ka bërë asnjë regjistrim në organet tatimore Unë vet s'kam bërë verifikime.

Brunilda Kadi: Okej, me çfarë provohet?

Fatmira Luli: Me deklaratimet e saj.

Brunilda Kadi: Okej! Mirë!

Fatmira Luli: Dhe kam qenë në pritje të kërkesave që ka parashtruar, kërkesa të cilat u gjetën të protokolluara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, unë i citova.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: E ka pasur ndonjëherë statusin?

Fatmira Luli: Për këtë nuk kam dijeni. Për këtë fakt nuk kam dijeni. Këtë le ta verifikojmë po qe se.

Brunilda Kadi: Unë thjesht dua informacioni pra.

Anëtarja e Komisionit thotë që nuk ka informacion nëse e ka patur apo jo statusin e nëpunësit gjatë kohës që ka punuar si specialiste në...

Naureda Llagami: Si është rekrutuar ajo si specialiste në Këshillin e Lartë?

Brunilda Kadi: Si është rekrutuar dhe a ka pasur statusin e nëpunësit dhe kjo ka lidhje me...

Naureda Llagami: Pra a ka ardhur me komandim? I është thënë se do të caktohesh me komandim, por që unë nuk besoj të jetë kështu apo i është nënshtruar provimit?

Brunilda Kadi: Unë thjesht mora indice nga pyetja që bëri Kryetarja në lidhje me {...}, që a ka pasur statusin e nëpunësit në Ministri? Dhe kjo zonja, zonja {...}, ka pasur statusin e nëpunësit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, derisa u bë inspektore?

Nuk ka informacion, me sa kam parë unë dosjen, nuk ka. Ndryshe do e kisha konstatuar. Dhe unë propozoj që për të njëjtën arsye, siç vendosëm edhe për znj. {...}, të shtyhet për t'u marrë ky informacion edhe nga tatimet edhe nga vetë administrata e Këshillit në lidhje me statusin e nëpunësit. Pastaj ka apo s'ka lidhje, le ta diskutojmë, por që edhe unë e vlerësoj që të jetë si informacion, sidomos ajo e tatimeve.

Naureda Llagimi: ... Pra dy çështje për t'u sqaruar nga ana e Komisionit, e para është lidhur me ushtrimin apo jo të profesionit të avokatisë dhe e dyta është lidhur me procedurat e rekrutimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse kanë qenë procedura në zbatim të ligjit "Për nëpunësin civil" apo kanë qenë procedura në zbatim të ligjit "Për pushtetin gjyqësor". Kështu që për këto dy çështje i spostojmë shqyrtimin e tyre në mbledhjen e radhës, duke vazhduar me çështjen tjetër. Ta hedhim në votim? Okej! E hedhim në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e fundit besoj, që është {...}.

Maksim Qoku: Faleminderit!

Atëherë inspektore {...} ka lindur në Dibër në datë 07.11.'52. Aktualisht është 67 vjeç, rreth 67 vjeç. Kështu që, pavarësisht relatimit që i kam bërë dhe që e keni në dokumentacion, unë si anëtar Komisioni kam kërkuar së pari moskonfirmimin, mospasjen së statusit të magjistratit dhe konstatimin e arritjes së moshës së pensionit për inspektoren në fjalë.

Brunilda Kadi: Mendoj që nëse Këshilli vendos që nuk ka status, ne s'kemi punë pastaj me pjesën e moshës për pension, se e para njëherë nuk e ka 67 si gjyqtar, e ka atë moshën tjetrën sipas ligjit "Për sigurimet". Dhe e dyta, që ishte e para, që s'e kemi ne kompetencë.

Kështu që mendoj, të kalojmë ndoshta tek diskutimi i parë, për pasjen apo jo, dhe në varësi të asaj, diskutojmë pjesën tjetër.

Naureda Llagami: Jeni dakord?

Atëherë fillojmë diskutimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Tjetër?

Fatmira Luli: Jo, nuk kemi propozim tjetër. Jemi me një propozim, që deklarohet mungesa e statusit dhe kaq.

Të tëra këto akte, duhet të shënohet, që janë akte individuale, që kanë të drejtën e ankimit, janë aty kështu që.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.10.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e znj. {...} si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
8. *Erion Fejzulla, USAID.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Valbona Bala, USAID.*
11. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
12. *Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e znj. {...} si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për komandimin e znj. {...} si pedagoge e brendshme në Departamentin e Formimit Fillestar të shkollës së Magjistraturës, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kush do ta relatojë projekt-aktin? Po, z. Toro ju lutem!

Alban Toro: Po, faleminderit!

Atëherë, më herët, me vendimin 62, 24.04.2019 nga ana e Këshillit është proceduar për dërgimin e emrave të kandidatëve të cilët kanë kandiduar për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës, të cilët kanë qenë {...} dhe {...}.

Me shkresën 828, datë 11.10.2019, pas procesit përzgjedhës, nga ana e Shkollës, është identifikuar si kandidatë fituese kandidatura e {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Ne rrethanat kur neni 54, pika 1, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar një afat maksimal të komandimit deri në pesë vjet, afat për të cilin dhe Shkolla e Magjistraturës ka kërkuar në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë se si rezultat i zbatimit të ligjit nr.84/2016, datë 06.10.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të ardhmen mund të ndodhemi në situatën e cenimit të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë kohëzgjatjes së periudhës së komandimit të gjyqtarës znj. {...}, kështu që në këtë kontekst, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar që në kuptim të nenit 57, pika 1, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin e komandimit të parashikohet edhe mundësia e ndërprerjes së komandimit përpara afatit kur një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme për interesin më të lartë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pra, për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të komandojë gjyqtaren znj. {...} në pozicionin e pedagoges të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat deri në pesë vjet. Të përcaktojë fillimin e afatit të komandimit më datë 15 nëntor 2019. Të përcaktojë që afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Si dhe, të urdhërojë përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarës znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë kontekst është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, ku dispozitivi përcaktuar se: Vendosi, komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat deri në pesë vjet. Afati i komandimit fillon më datë 15 nëntor 2019. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarës znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve

gjqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky pak a shumë është edhe propozimi.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim?

Brikena Ukperaj: Kam një diskutim lidhur me afatin e komandimit sepse nuk është i përcaktuar në mënyrë të saktë në vendim se sa është. Duke lënë një afat deri në 5 vjet, nënkuptohet që mund të jetë një, mund të jetë dy, mund të jetë tre, mund të jetë katër, po mund të jetë edhe pesë.

Në fillim kur është bërë shpallja e procedurës së komandimit është lënë afat deri në 5 vjet sepse nuk kishim një informacion nga shkolla se sa kishte vendosur Këshilli Drejtues/Bordit për afatin brenda të cilit do të merrte si të komanduar një gjyqtar në pozicionin e pedagogut të brendshëm.

Shkresa që ka ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, afati është i përcaktuar për një periudhë 5-vjeçare. Prandaj unë mendoj që afati duhet të jetë i përcaktuar qartë. Pastaj, pika e tretë e shpreh edhe atë merakun që ne kemi. Në rast se dëmtohet funksionaliteti i gjykatës, sigurisht që ky komandim do të ndërpritet. Thënia deri në 5 vjet nuk është se bie në kundërshtim me pikën 3, thënia, më falni, domethënë, e një afati të përcaktuar, sa do jetë për shembull, një afat 5-vjeçar, pastaj ky afat mund të ndërpritet edhe para mbarimit të 5 viteve në qoftë se dëmtohet funksionaliteti. Por mendoj që në vendim afati duhet të jetë i përcaktuar. Ne mund të mendojmë për një afat më të shkurtër, mund të mendojmë tre vjet. Hajde ta vendosim. Por mendoj që duhet të jetë i përcaktuar saktë afati i komandimit.

I saktë, i përcaktuar. Kjo është.

Naureda Llagami: Ta ndryshojmë?

Komisioni, keni ndonjë propozim tani me sugjerimin e znj. Ukperaj, ta rishikojmë pjesën e afatit apo...?

Alban Toro: Besoj që nuk ka vend për rishikim sepse ne nuk kemi thënë gjë tjetër përveçse faktit, për të krijuar edhe stabilitetin për shkollën, afat 5-vjeçar, deri në 5 vjet (pra përfshin harkun kohor 1 deri në 5). Fakti i cenimit të funksionalitetit të gjykatës na ka bërë që ta modulojmë në këtë formë, pasi parashikimet, ndonëse edhe më optimiste, nuk të çojnë në faktin që edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk do të cenohet

funksionaliteti për shkak të aplikimit të ligjit për vettingut, kështu që në këtë kontekst është parashikuar që ky afat të ndërpritet menjëherë dhe prandaj është vendosur kjo formë e të shprehurit, pra nuk është se ka ndonjë ndryshim në fund fare, 5-vjeçari mbetet.

(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban Toro: Deri në 5 vjet.

Marçela Shehu: Ajo që thotë Brikena, me sa e kuptoj unë, nuk është se është kundër pikës 3.

Naureda Llagami: Jo, jo, është pika 1.

Marçela Shehu: Të ndërpritet nëse cenohet funksionaliteti, por me çështjen e terminologjisë dhe me afatin e përcaktuar saktë.

Naureda Llagami: Të jetë më konkret. Këtë e thotë ligji. Edhe unë me këtë jam. Okej!

Brikena Ukperaj: Keni menduar që mund ta lejmë për shembull për një afat 5-vjeçar dhe pastaj të vendosim që ky afat mund të ndërpritet edhe më përpara nëse dëmtohet funksionaliteti i gjykatës?

Mund të themi edhe 4. Mund të themi edhe 3. Se s'është se... 5 na e ka kërkuar Shkolla.

Pika 1: "...për një afat 5 vjet", -kaq.

Naureda Llagami: Atëherë votojmë projekt-aktin? Jemi dakord me projekt-aktin?

Maksim Qoku: Të them edhe diçka, të lutem!

Ju lutem, për relatorin më tepër. Kam idenë se është e nevojshme të rregullohet edhe problemi i efekteve financiare, sepse në bazë të 263 pika 4 dhe 265, pedagogu merr statusin e gjyqtarit të apelit, por problemi është se a na duhet neve, pasi më duket se nuk del mirë nga këto nenet që kush e bën pagesën.

(Anëtarët përgjigjen njëherazi pa ndezur mikrofonat "Shkolla e Magjistraturës".)

A mund ta bëjmë në mënyrë të shprehur apo duhet ta lejmë në aspektin që e nxjerr ligji?

Mua s'më duket se.

Okej! E rregullon ligji.

Okej! Ky është mendimi i relatorit. Okej. Faleminderit!

Naureda Llagami: Unë jam dakord sepse unë dua të qëndroj konsistente tek vendimmarrja që kemi marrë më datë 04.03.2019, ku unë personalisht kam qenë votë 'kundër' lidhur me kriteret që kemi aplikuar për pedagogët e brendshëm, duke qenë se jam e mendimit dhe vazhdoj t'i qëndroj mendimit që ne duhej të respektonim ligjin "me 15 vjet eksperiencë pune si gjyqtar dhe prokuror dhe 10 vjet eksperiencë si pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.

Ky është qëndrimi im, të cilin unë do vazhdoj ta mbaj, thjesht për të sqaruar votën time. Nuk kam asnjë gjë lidhur me kandidaturën, të cilën personalisht e vlerësoj, por është një qëndrim konsistent.

Brunilda Kadi: Atëherë, dua të sqaroj edhe unë.

Edhe pse unë kam votuar njëloj si edhe Kryetarja, por ishte në lidhje me opinionin, kur dhamë opinionin për Shkollën. Edhe unë e kam interpretuar ligjin, ashtu si dhe tha Kryetarja. Tani ky është një moment i dytë, që Këshilli, me shumicë votash vetë votoi ndryshe dhe nuk ka më lidhje tani, nuk ka më rëndësi opinionin ynë si lexohet ligji. Ligjin e kanë lexuar të tjerët tani. Është organi tjetër kompetent që e ka përcaktuar, është Shkolla e Magjistraturës. Kështu që, mendoj që kjo vendimmarrje në lidhje me këtë moment nuk ka lidhje me atë të parin. Kështu që, thjesht sqarova dhe pozitën time në lidhje me votimin e parë dhe votën time, që kur të më vijë radha do e them që jam pro.

Ilir Toska: Nuk mund të vejmë në diskutim të gjithë vendimet e mëparshme, që meqenëse herën e parë, para disa muajsh thashë kështu, e do vazhdojmë. Nëse ka dikush kundër për këtë, të thotë kam këtë kundër për këtë arsye. Nuk i bie që kam pas njëherë arsye në fillim. Unë s'e kuptoj kështu.

Naureda Llagami: E kalojmë në votim projekt-aktin me sugjerimin që bëri zonja Ukperaj. Afati 5 vjet.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, Këshilli vendosi me shumicë votash: Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat pesë vjet. Afati i komandimit fillon më datë 15 nëntor 2019. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.10.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
8. *Erion Fejzulla, USAID.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Valbona Bala, USAID.*
11. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
12. *Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtares {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër sipas rendit të ditës. Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtares {...}. Atëherë lidhur me këtë projekt-akt, fjalën ia jap zonjës Marçela Shehu. E ka kryetari! Zoti Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, është përgatitur një projektvendim “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zonjës {...}”, për të cilën është përgatitur edhe relacioni përkatës.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.10.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Në rastin konkret, dorëheqja e znj. {...} është bazuar në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit: “Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Si motiv të dorëheqjes znj. {...} ka parashtruar angazhimin e saj në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor, konkretisht në pozicionin e Përgjegjëses së Zyrës Juridike pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pozicion pune që i ishte ofruar më datë 11.10.2019, ofertë pune të cilën e kishte pranuar, por që, sipas kërkesës së punëdhënësit, marrëdhënia e punës do duhet të fillonte më datë 01.11.2019, pra përpara afatit kur dorëheqja e saj jep sipas ligjit efekte, pra në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, pra më datë 30.11.2019.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 01.11.2019, ditë kur ajo do të duhej të fillonte punë pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Marrë shkas nga kërkesa e motivuar për dorëheqje nga statusi i magjistratit e znj. {...}, me qëllim për të vlerësuar moscenimin e interesit publik nga dhënia efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor, u kërkua informacion nga gjykata ku znj. {...} ushtron detyrën e gjyqtarës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me shkresën nr. 8038/3 prot., datë 18.10.2019, ka informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se largimi nga puna për shkak të dorëheqjes të znj. {...} mendohet se do të sillte ndikim në ngarkesën e çështjeve gjyqësore tek gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate, por referuar çështjeve që znj. {...} kishte për gjykim aktualisht, nuk vihej re ndonjë situatë negative e pakthyeshme për dhënien e drejtësisë.

Sipas listës së çështjeve të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtarja {...} ka aktualisht për gjykim 193 çështje gjyqësore në lëndë civile. Nga këto, 174 janë çështje themeli, nga të cilat për 5 nga ato gjykimi është pezulluar. Nga 169 çështjet e themelit, 1 çështje është regjistruar në vitin 2016, 7 çështje në vitin 2017, 36 çështje në vitin 2018 dhe pjesa tjetër në vitin 2019. Në totalin e çështjeve përfshihen edhe 18 kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi, 2 kërkesa civile dhe 9 kërkesa për regjistrim apo depozitim aktesh në regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtares znj. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit. Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Së dyti, kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtarja në fjalë ka parashtruar një motiv për dorëheqjen e saj, motiv ky që, përveç se personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar. Së treti, dhënia e efekteve të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarrëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtares znj. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtares nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtarja mund të përfundojë gjykimin e atyre çështjeve që mund të jenë në fazën e fundit të gjyqimit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ajo. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data 31.10.2019 duket që konsideron të dyja ato.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendosë: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status; Efektet e këtij urdhërimi të fillojnë më datë 31.10.2019; Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Mund ta lexoj edhe formulimin që është në projektvendim.

“Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin “e angazhimit në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor”, me propozim të

Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.10.2019. 3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 4. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. 5. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë sugjerim, koment apo diskutim mbi projekt-aktin?

Jo!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së

motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.10.2019. 3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 4. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. 5. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit. 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.10.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
8. *Erion Fejzulla, USAID.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Valbona Bala, USAID.*
11. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
12. *Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër, sipas rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur ky projekt-akt nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Nga kush do relatohet?

Nga zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 104, datë 04.11.2016, ka vendosur komandimin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, z. {...}, si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 3-vjeçare. Komandimi i këtij

gjqytari është bërë bazuar në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit periudha prej 3 vitesh ishte periudha maksimale e komandimit. Si e tillë, kjo periudhë komandimi pranë Gjykatës së Lartë përfundon më datë 04.11.2019.

Rezulton se z. {...} është komanduar si këshilltar ligjor pranë Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}, i cili ishte edhe kryetari i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë ndihmës magjistrati, {...}, ka punuar gjatë gjithë periudhës së parë të komandimit pranë Kolegjit Administrativ.

Në referim të nenit 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, kryetari i Gjykatës së Lartë, 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë, ka paraqitur pranë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmës magjistratit, z. {...}, si i komanduar në Gjykatën e Lartë.

Kështu, me anë të shkresës nr. 1717/1 prot., datë 11.06.2019, Gjykata e Lartë ka kërkuar konfirmimin për një periudhë 1-vjeçare të ndihmës magjistratit {...}, si i komanduar në Gjykatën e Lartë. Në këtë shkresë, theksohet se në kushtet që aktualisht rezulton që Gjykata e Lartë ka vetëm 4 ndihmës magjistratë të komanduar, ndërkohë që në referim të nenit 34, pika 4 të ligjit nr. 98/2016, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë të njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë duhet të përbëhet nga ndihmës magjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për Statusin, kryetari i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme që Këshilli të vendosë konfirmimin e z. {...} si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë, duke përsëritur komandimin e tij për një periudhë 1-vjeçare.

Gjithashtu rezulton që z. {...}, më datë 11.06.2019, ka dhënë pëlqimin për t’u konfirmuar si ndihmës magjistrat, duke kërkuar përsëritjen e komandimit me një vit. Sipas vlerësimit të gjyqtarit, eksperiencia e deritanishme pranë Gjykatës së Lartë, ka qenë e tillë që ka lejuar të kontribuojë në mbarëvajtjen e punës së autoritetit më të lartë gjyqësor dhe njëkohësisht e ka zhvilluar atë profesionalisht.

Në kuadër të trajtimit të kërkesës së paraqitur për konfirmimin e komandimit të z. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka kërkuar një informacion Gjykatës së Lartë lidhur me organizimin aktual të punës së ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë.

Në përgjigjen e ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr.2495/1 prot datë 16.10.2019, ndër të tjera referohet se: në Gjykatën e Lartë ka gjithsej 4 ndihmës

magjistratë dhe 5 këshilltarë ligjorë që përbëjnë organikën efektive të ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë. Deri në vitin 2018, ndihmësit ligjorë ishin të caktuar dhe punonin pranë një gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Për shkak të numrit të pakët të gjyqtarëve të mbetur dhe përgatitjeve për të ndërtuar Njësinë Ligjore të Gjykatës së Lartë, u mendua dhe u vendos që këshilltarët të riorganizoheshin dhe të ndaheshin sipas kolegjeve. Këshilltarët u ndanë në tre kolegje, sipas llojit të çështjeve për të cilat kryhej puna hulumtuese dhe përgatitore. Kështu, në Kolegjin Administrativ ushtrojnë detyrën: {...}, {...} dhe {...}; në Kolegjin Civil: {...}, {...} (e cila rezulton të jetë bashkëshortja e z. {...}), {...} dhe {...}; ndërsa në Kolegjin Penal ushtrojnë detyrën: {...} dhe {...}.

Në referim të kësaj shkrese të dërguar nga ana e Gjykatës së Lartë, në çdo rast puna dhe përgjegjësia e secilit prej ndihmësve ligjorë është e ndarë, individuale dhe finalizohet me relativimin para relatorit të çështjes dhe më tej edhe para trupit gjykues. Ndhmësit ligjorë nuk ngarkohen të punojnë në grupe dhe nuk punojnë me njëri-tjetrin në punën hulumtuese dhe përgatitore të çështjes që i ngarkohet. Secili prej tyre është i lidhur gjatë gjithë procedurës gjyqësore të shqyrtimit të një çështjeje të caktuar me çështjen e cila i është ngarkuar dhe me gjyqtarin relator apo më tej me trupën gjyqësore. Në këtë mënyrë do të bëhet dhe organizimi i punës ndërmjet ndihmësve ligjorë dhe trupës gjyqësore në të ardhmen, pas krijimit të Njesisë Ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

Sipas informacionit të ardhur nga Gjykata e Lartë, vetë Gjykata e Lartë është kujdesur dhe kujdeset që në mënyrën se si organizohet veprimtaria përgatitore e çështjeve gjyqësore, të eliminohet çdo mundësi për ekzistencën e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë ndërmjet gjyqtarëve, ndërmjet gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë dhe ndërmjet ndihmësve ligjorë.

Më poshtë kam referuar situatën ligjore. Kemi parashikimin e nenit 34 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, dispozitë e cila rregullon organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, si dhe parashikimin e nenit 56 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ku përcaktohen kushtet dhe kriteret e komandimit në Gjykatën e Lartë, dispozita të cilat nuk po i citoj.

Lidhur me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës:

Duke u bazuar në rrethanat faktike të cilat unë i parashtrova më sipër dhe në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se kërkesa e paraqitur është në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kështu në rastin konkret rezulton se: kemi një kërkesë të motivuar të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Lartë për konfirmimin e ndihmës magjistratit z. {...} në Gjykatën e Lartë, ku referohet dhe nevoja konkrete e konstatuar nga gjykata; kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga ligji, pra 3 muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit; si dhe gjyqtari {...} ka dhënë pëlqimin e tij për konfirmim.

Lidhur me faktin se, në Gjykatën e Lartë, aktualisht ushtron funksionin e ndihmës magjistratit edhe bashkëshortja e z. {...}, znj. {...}, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, në referim të pikës 6 të nenit 8 të ligjit 96/2016, ndryshuar me ligjin nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016...”, në kushtet kur, papajtueshmëria ambientale – pasi Komisioni vlerëson se në rastin konkret jemi në kushtet e papajtueshmërisë ambientale – Komisioni vlerëson se në kushtet kur kjo papajtueshmëri është krijuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit dhe kërkesa e motivuar për konfirmimin e komandimit të z. {...} nga kryetari i Gjykatës së Lartë është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, lidhur me konfirmimin e komandimit të z. {...}, rregullat e përcaktuara në nenin 8 të ligjit të sipërcituar, lidhur me papajtueshmërinë ambientale, nuk gjejnë zbatim.

Në vlerësimin e bërë, Komisioni bazohet dhe në organizimin aktual të punës në Gjykatën e Lartë, siç u parashtrua më sipër, ku konstatohet që Gjykata e Lartë ka marrë të gjitha masat për shmangien e të gjitha situatave të papajtueshmërisë apo konfliktit të interesit ndërmjet ndihmës magjistratëve që ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës së Lartë, me qëllim garantimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë: Të konfirmojë si ndihmës magjistrat në Gjykatën e Lartë gjyqtarin {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, ndonjë çështje për diskutim para se të kalojmë...? Po!

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Do të desha të shtoja vetëm diçka që, meqë ju e dini që kemi ngritur grupin e punës për Hartën Gjyqësore edhe zoti {...} është edhe anëtar i grupit të punës dhe personi që është autorizuar nga ish-kryetari i Gjykatës së Lartë por që është në përfaqësim të Gjykatës së Lartë tek ky grup dhe aktualisht meqë ka kaluar dhe një periudhë mbi 6 muaj që po punohet me grupin e punës për Hartën Gjyqësore dhe normalisht ne kemi ngarkuar detyra mbi njëri-tjetrin dhe po bëhemi gati për të përpiluar tre projekt propozimet dhe po punojmë mbi materialin, në një aspekt të tillë edhe zoti {...} është i angazhuar në fakt në këtë punë. Kështu që, do isha edhe unë pro me një argument më tepër për të shtyrë dhe 1 vit qëndrimin e tij pranë Gjykatës së Lartë për efektin e mbarimit të asaj çka ai ka marrë përsipër si angazhim. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Unë kam diçka tjetër për të shtuar.

Tani, kërkesa e kryetarit dhe miratimi i gjyqtarit janë dhënë para hyrjes në fuqi të nenit 8 të ligjit 96 që bën fjalë për papajtueshmërinë ambientale dhe jam dakord siç relatoi dhe Marçela që kjo është një situatë me pajtueshmëri që në këndvështrim të këtij ligji është krijuar para hyrjes në fuqi të ligjit. Dukë qenë që ne sot marrim parasysht një kërkesë, marrim në analizë një kërkesë të kryetarit të gjykatës para hyrjes në fuqi të këtij ligji, unë vlerësoj që vetë gjyqtari duhet të bëjë një vetëdeklarim sipas këtij ligji, që ai si e çmon vazhdimin e mëtejshëm, e çmon që është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale apo nuk është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, sepse miratimi i gjyqtarit është dhënë para hyrjes në fuqi të ligjit.

Referuar dispozitave tranzitore të ligjit 96 të vitit 2016 çdo magjistrat duhet të informojë për gjendjen e papajtueshmërisë ambientale brenda një muaji nga krijimi i Këshillit, -thuhet në ligj, por në këtë rast, dispozita e papajtueshmërisë ambiental nuk ka qenë në fuqi, ka qenë e shfuqizuar.

Kështu që mendoj, para se të shprehemi, qoftë dhe për procedurë, por dhe për të parë dhe mënyrën se si e vlerëson vetë magjistrati, të merret një vetëdeklarim i zotit {...} në rastet nëse ai e vlerëson është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale apo jo. Duhet të bëjë vetëdeklarim që unë nuk jam në kushtet e papajtueshmërisë ambientale sepse miratimin e ka dhënë para se të hynte në fuqi ligji dhe nuk ka pasur dispozitë që rregullonte papajtueshmërinë ambientale.

Ndoshta gjyqtari e vlerëson edhe vetë që nuk është në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)

Ndoshta gjyqtari nuk e di që ne sot po e shqyrtojmë këtë kërkesë.

Marçela Shehu: Kam përshtypjen se nëse gjyqtari do të kishte vlerësuar një situatë tjetër apo do ishte tërhequr dhe nuk do ishte më dakord me atë kërkesë që ka paraqitur, besoj që do e kishte vënë në dijeni Këshillin me një kërkesë të dytë, ku do ishte tërhequr.

Brikena Ukperaj: Ta marrim të mirëqenë që gjyqtari ka pëlqim për të vazhduar sepse nuk e çmon që ka papajtueshmëri ambientale.

Marçela Shehu: Unë personalisht kuptoj që, e marr të mirëqenë faktin që gjyqtari i qëndron kërkesës që ka paraqitur.

Brikena Ukperaj: Kërkesa në fakt është nga kryetari i gjykatës

Marçela Shehu: Është konfirmuar dhe ka dhënë pëlqimin, ka dhënë dhe shkaqet pse e kërkon pëlqimin sepse kam kontribuar thotë dhe rritem profesionalisht.

Këtë po them, që gjyqtari, sikurse edhe ne, është në dijeni të të gjitha ndryshimeve ligjore edhe që aktualisht kemi nenin 8 në fuqi...

Brikena Ukperaj: Unë bëra një propozim. Si ta vlerësojë Këshilli.

Marçela Shehu: Kjo mund të hidhet në votim, por unë mendoj që nëse ai do të kishte një mendim ndryshe besoj do të na kishte vënë në dijeni.

Naureda Llagami: Jo, në fakt, dua ta çoj më tej debatin.

Në fakt, se duket sikur ligji, ligji ka parashikuar ndryshimet ligjore, ka bërë një situatë rregullimi të papajtueshmërisë ambientale, nga ana tjetër, në dispozitat kalimtare, shohim një, të paktën atë që referoi Brikena, që thotë që magjistrati informon gjendjen e papajtueshmërisë ambientale brenda një muaji nga krijimi i këshillave respektivë, -që është neni 169, pika 4. Për ta ditur, duke marrë rastin e {...}, por për ta pasur parasysh dhe në vijim të zbatimit, -a është e nevojshme që nga komisionet përkatëse të kërkohet magjistrati duhet automatikisht...?

Si do ta lexojmë këtë dispozitë?

Duhet automatikisht...?

Jo, jo, s'po them për këtë. Në rastin e {...} po, por po e marr që meqë na ndodhi rasti i {...}, ta dimë edhe si do jemi në vijimësi. Pra çdo magjistrat që është duke punuar, duhet automatikisht të bëjë informim Këshillit për gjendjen e papajtueshmërisë dhe ne do të vlerësojmë?

Po të shkosh tek 169, pika 4...

(Zonja Shehu flet pa ndezur mikrofonin.)

Jo pra jo, se s'është 8. Këtë po diskutojmë. Shkojmë tek 169 dhe unë dua që në vijim, se okej rastin e {...} e kemi në diskutim dhe e kalojmë në vendimmarrje, por 169, pika 3, kur flet për dispozitat kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve, ku rregullon se si është detyrimi i magjistratit të informojë Këshillin dhe për lejet dhe për detyrat jashtë funksionit, një nga pikat që ka, thotë: Informon dhe për gjendjen e papajtueshmërisë ambientale brenda një muaji nga krijimi i këshillave.

Kjo situatë në fakt ishte një situatë që ne deri tani nuk e aplikojmë sepse është një situatë që mendonim që pa pasur një dispozitë materiale s'i kalojmë.

A ka mundësi ta mbaroj unë dhe pastaj ti?

Ajo që diskutojmë është se si do të veprojmë? Kjo është e pritshme që të gjithë magjistratët tashmë, në ushtrimin e funksioneve të tyre, duhet të na çojnë informacion për gjendjen e papajtueshmërisë që ne të dimë si është situata në sistem?

Ilir Toska: Ajo dispozita kalimtare ka të bëjë më rregullimet që ka pasur ligji përpara shfuqizimit. 169/8 u shfuqizua ndërkohë. Nëse kjo duhet të kishte ndodhur, duhet të kishte ndodhur shumë më përpara shfuqizimit.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Atëherë, kam përshtypje që papajtueshmëria ambientale është neni 8, që është shfuqizuar. Neni 169, që referonte 8-ta, nuk di sa mund të vlejë kur vetë 8-ta u shfuqizua. Tani, si mund ta vë në diskutim që... ?

(Zonja Llagami flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Toska: Jo pra, se ka rregulluar një gjë tjetër po tek 8-ta.

(Zonja Llagami flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Vazhdon të qëndrojë në fuqi informimi. Kjo është çështja që ngre unë. A duhet të na informojnë ne magjistratët...

Ilir Toska: Po pra po, të na informojë, por në përshtatje me 8-ën.

Brunilda Kadi: Tani, kam përshtypjen që dispozita 8-ta që kërkon vetëdeklarimin, ka të bëjë se rastet e papajtueshmërisë janë fakte që i di magjistrati se Këshilli nuk mund ta dijë automatikisht që ka kushëri deri në shkallë të dytë apo e ka bashkëjetues apo bashkëjetuese apo qoftë edhe bashkëshort (larg qoftë), ne nuk e dimë gjendjen e magjistratëve sot dhe kam përshtypjen që... jo, që janë bashkëshortë deri në momentin që kemi...

Larg qoftë, e kisha që të mos jenë më bashkëshortë, që të sqaroheshim, por besoj ishte e kuptueshme.

Në momentin kur është sjellë kërkesa dhe është bërë deklarimi, ne na rezulton që ata kanë qenë në atë moment bashkëshortë dhe është deklaruar ajo që ka deklaruar magjistrati. Kurse ajo që kërkohej nga dispozita është thjeshtë që mund të kenë ndryshuar rrethanat më mbrapa apo një situatë që s'kemi nga ta dimë dhe kam përshtypjen që nuk është detyrim ajo është në përgjegjësinë e atij. Nëse ky fakt është i pandryshueshëm, ai e di vetë detyrimin që ka apo s'ka papajtueshmëri dhe fakti që i qëndron kërkesës, do të thotë që ai deklaron që s'ka papajtueshmëri.

Këtë mendim keni ju si Komision, që ai këtë gjendje...?

Ilir Toska: Fakti që këta të dy janë bashkëshortë atje ku janë është i ditur. Nuk është se duhet të na lajmërojë dikush tjetër. E kemi të ditur dhe e kemi relatuar. Po tani, nëse doni që të thotë prapë ai që kam bashkëshorten këtu, - Okej, ta thotë prapë. Nuk e di!

Marçela Shehu: Nuk po mohohet nga dikush, as nga Komisioni as nga gjyqtari që ka bërë kërkesën që ata janë të martuar dhe vazhdojnë të jenë të martuar.

Brikena Ukperaj: Deklarimi i papajtueshmërisë nuk ka lidhje në këtë rast vetëm me faktin e lidhjes por ka edhe me fakte të tjera që kur është krijuar dhe si vetë gjyqtari e vlerëson.

Marçela Shehu: Edhe këtë është një fakt që ne e dimë se kur është krijuar.

Brikena Ukperaj: Po pra, por vetë gjyqtari duhet të shprehet dhe ta vlerësojë këtë situatë faktike në të cilën ai ndodhet, nuk mund ta vlerësojmë ne, duhet edhe vetë gjyqtari. Pra ai mendon që nuk është në situatën, duhet ta nënkuptojmë që për sa kohë nuk ka një deklaram tjetër të pas hyrjes në fuqi të ligjit, të interpretojmë që ai nuk e konsideron...

Gjyqtari nëse nuk e deklaron papajtueshmërinë ambientale, ai mban përgjegjësi disiplinore, shkelje disiplinore sipas ndryshimeve dhe në këtë rast papajtueshmëria ambientale nuk lidhet vetëm me faktin e lidhjes së afërt gjinore, por lidhet dhe me momentet e hyrjes në fuqi të ligjit, momentin që Këshilli do të bëjë një zgjatje të afatit dhe unë mendoj që gjyqtari, për të gjitha këto duhet të shprehet dhe duhet të deklarojë, të vetëdeklarimin në kuadër të nenit 8. Kjo ishte.

Naureda Llagami: Atëherë, çfarë na kushton që ne t'i çojmë një shkresë dhe ne të enjten do mblidhemi prapë dhe e fusim direkt vetëm për këtë çështje. Saktësojmë edhe këtë, duke qenë se është praktikë e parë, le ta marrim praktikën të plotë dhe më pas ditën e enjte, kur do mblidhemi, e fusim në rendin e ditës.

Si është informacioni? Kemi kohë? Kur i mbaron data e komandimit?

Atëherë kemi kohë. Ne të enjten do mblidhemi prapë.

Marçela Shehu: Kam përshtypjen që anëtarët nuk po kërkojnë të deklarojë faktin, pra është apo jo i martuar, por në ndërgjegjen juridike të gjyqtarit, a ka vend për papajtueshmëri ambientale apo jo. Unë kështu e kuptoj. Pra nuk kërkohet vetëm deklarim.

Tani, në qoftë se është shkelje disiplinore, besoj gjyqtari e merr parasys.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord me propozimin që t'i kërkojmë vetëdeklarimin, konform nenit 8 të ligjit të ndryshuar?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

(Vota e zonjës Ukperaj nuk dëgjohet.)

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Do vazhdojmë.

Atëherë, kalojmë tek shqyrtimi i projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Brunilda Kadi: Një sekondë Kryetare, se do shpjegoj votën kundër.

Atëherë, unë vlerësoj që ka papajtueshmëri ambientale dhe mendoj që kjo është arsyeja – edhe për arsyen tjetër procedurale që u shpreha më përpara, por për arsye materiale, mendoj që ka papajtueshmëri materiale dhe prandaj votova kundër.

Brikena Ukperaj: Edhe unë, për të njëjtin shkak që ka Bruna, vlerësoj që ka papajtueshmëri ambientale, veç faktit që mungon edhe deklarata që duhet të ishte element i procedurës sepse vlerësoj që pavarësisht që kjo papajtueshmëria ambientale është krijuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur dispozita ishte shfuqizuar, me hyrjen në fuqi të ligjit dhe me detyrimin për t'u shprehur Këshilli lidhur me vijueshmërinë ose me zgjatjen e afatit të komandimit, Këshilli është detyruar që ta marrë në shqyrtim rastet e nenit 8 dhe neni 8 e ka të shprehur në mënyrë të qartë që s'mund të jenë të dy në një gjykatë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor